

**VLERËSIMI I RREZIQEVE PËR SIGURINË KOMBËTARE / AFTËSIA E  
SHTETIT E SHOQËRISË PËR TË REAGUAR: LINDJA E NJË NDIKIMI TË  
RI RADIKAL DHE EKSTREMIZMI FETAR NË SHQIPËRI**

**Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë**

**2015**



**Realizmi i këtij studimi u bë i mundur me mbështetjen financiare të  
Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë**

**Autor: Enri Hide**

**Grafikët: Piter Duma**

## Abstrakt

Ky është një studim i thelluar mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin fetar në Shqipëri i Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare (ISSHN), me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur në Shqipëri. Studimi ka si qëllim të paraqesë një analizë të detajuar, realiste dhe gjithëpërfshirëse të këtij fenomeni me përmasa sa kombëtare aq dhe rajonale e ndërkombëtare. Ai synon të ofrojë një hartë të plotë të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, duke analizuar zhvillimin e tij në Shqipëri, faktorët që kanë kontribuar në këtë proces, si dhe aspektet ideologjike, ekonomike e sociale të tij. Nga ana tjetër, ai analizon zonat gjeografike më të prekura në Shqipëri, nxitësit socialë që kontribuojnë në radikalizimin e qytetarëve shqiptarë, ndikimin e faktorëve të jashtëm si dhe dinamikat më të përgjithshme të zhvillimit të fenomenit gjatë kësaj periudhe, për të kuptuar më mirë implikimet për sigurinë kombëtare dhe për vetë zhvillimin e vendit. Ai shqyrton shkaqet e shumëfishta të radikalizmit në Shqipëri dhe kapacitetin e shtetit dhe të shoqërisë për të reaguar ndaj ekstremizmit. Studimi ofron gjithashtu një qasje krahasimore të dinamikës së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar edhe në raport me vendet e tjera të rajonit. Synimi i këtij studimi është të gjenerojë rekomandime për aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë për t'u përballur me këtë fenomen dhe për të minimizuar pasojat tij, që kërcënojnë në thelb kohezionin kombëtar.

Së fundi, siç edhe rezultoi nga Konferenca Rajonale mbi Sigurinë, e mbajtur në maj të vitit 2015, synimi i këtij studimi është të argumentohet se radikalizmi islamik dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri, me tendenca të qarta kah islamit politik, me rritjen e numrit të qytetarëve shqiptarë që kanë marrë pjesë në konfliktet në Siri dhe Irak gjatë 3-4 viteve të fundit dhe me krijimin e rrjeteve ekstremiste rajonale, përbën kërcënim potencial për sigurinë kombëtare. Rritja e grupeve xhihadiste dhe zgjerimi i influencës së tyre përbën jo vetëm kërcënim të sigurisë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, por përmban edhe rrezikun e cënimit të harmonisë fetare, çka do të ishte fatale për sigurinë, stabilitetin, madje edhe për të ardhmen e vendit.

## STRUKTURA

1. Hyrje
2. Konteksti global dhe rajonal
3. Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi islamik në Shqipëri
  - 3.1. Feja, shoqëria dhe politika
  - 3.2. Tranzicioni, demokratizimi dhe radikalizmi fetar
  - 3.3. Përfshirja e shqiptarëve në Siri dhe Irak
  - 3.4. Gjeografia e fenomenit
  - 3.5. Shkaqet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit islamik në Shqipëri
  - 3.6. Procesi i radikalizimit: nevoja e një modeli
  - 3.7. Rëndësia e familjes në luftë: gratë dhe fëmijët në Siri dhe Irak
  - 3.8. E kaluara kriminale e ekstremistëve
  - 3.9. Kthimi në shtëpi: ri-integrimi dhe de-radikalizimi
  - 3.10. Reagimi i shtetit: ndryshimet e kuadrit ligjor, ri-strukturimi institucional, strategjia e qeverisë për t'u përballur me fenomenin
    - 3.10.1. Kuadri ndërkombëtar
    - 3.10.2. Kuadri legjislativ
    - 3.10.3. Kuadri strategjik
  - 3.11. Reagimi i shoqërisë dhe i KMSH
  - 3.12. Impakti në integrimin e Shqipërisë në BE
4. Përfundime dhe rekomandime
5. Metodologjia
6. Bibliografia

## 1. Hyrje

Shqipëria, sikurse i gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor, është përfshirë vitet e fundit nga një valë ekstremizmi të dhunshëm dhe radikalizmi fetar. Ndonëse në fazë fillestare, ekstremizmi dhe radikalizmi përbëjnë kërcënime potenciale për sigurinë kombëtare të vendit. Ky problem është bërë edhe më i mprehtë për shkak të pjesëmarrjes së qytetarëve shqiptarë në konfliktet në Siri dhe Irak dhe rikthimit të tyre në atdhe, pas luftimeve. Situata është përkeqësuar veçanërisht pas vitit 2011, për të arritur nivelin më të lartë në vitin 2014. Ky studim ka për qëllim të analizojë, monitorojë dhe vlerësojë këtë fenomen—duke pasur parasysh kompleksitetin e tij si në nivel shtetëror ashtu dhe ndërkombëtar—si dhe të ofrojë rekomandime të mundshme të përballjes me të për aktorë të ndryshëm.

Studimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit islamik fillon me shqyrtimin e imtësishëm të literaturës bashkëkohore të fenomenit për të sqaruar konceptet mbi të cilat do të ndërtohet analiza, tiparet strukturore dhe strategjike të ekstremizmit, për t'u ndalur tek risia e këtij fenomeni, që qëndron në territorializimin e terrorizmit, duke u shndërruar në faktor strategjik dhe gjeopolitik. Ai do të fokusohet tek situata e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar në Shqipëri, duke analizuar jo vetëm faktorët historikë, por në mënyrë të veçantë shkaqet e shumëfishta të ekstremizmit fetar dhe radikalizmit islamik në ditët e sotme. Synimi i tij është të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar të faktorëve, pasojave dhe reagimin respektiv shtetëror e social të përballjes me këtë fenomen.

Premisa kryesore prej nga zë fill analiza është keqpërdorimi dhe instrumentalizimi i fesë myslimane për të përlegjur ekstremizmin e dhunshëm dhe pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm shqiptarësh (në raport me popullsinë e vendit) në konfliktet në Siri dhe Irak. Prandaj, ky studim bazohet në teorinë e sigurizimit, e cila ofron qasjen më të plotë rreth procesit të sigurizimit të fesë dhe shndërrimit të keqinterpretimit të fesë islame në sfidë për sigurinë kombëtare. Ndërsa nga pikëpamja empirike, ai bazohet në shqyrtimin e burimeve të shumëfishta të informacionit mbi qytetarët shqiptarë të përfshirë në luftime në Siri dhe Irak, pas një monitorimi intensiv mediatik të veprimtarisë

ekstremiste për një periudhë trevjeçare. Informacionet janë kryqëzuar me të dhënat zyrtare të shtetit shqiptar dhe burimeve të tjera të huaja, zyrtare dhe mediatike. Gjithashtu në të janë përfshirë një sërë gjetjesh të rëndësishme dhe të vlefshme të sondazhit të zhvilluar nga AIIIS mbi perceptimin e opinionit publik rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar në Shqipëri.

Një pjesë të rëndësishme në analizën e radikalizmit islamik zë shpërndarja dhe përqendrimi gjeografik i individëve të indoktrinuar me ideologji fetare ekstremiste, të përfshirë në radhët e organizatave terroriste në Irak dhe Siri, si dhe analiza e mjedisit të tyre ekonomik, social dhe arsimor. Për të përfutur gjetje dhe përfundime sa më shkencore, është përdorur një model interpretimi i të dhënave që e sheh radikalizimin si proces me disa etapa. Kjo lehtëson një qasje më të strukturuar për të kuptuar fenomenin e ekstremizmit islamik në Shqipëri, duke qartësuar dhe impaktin real të çdo strategjie apo plan-veprimi në përballje me të, për secilën fazë. Studimi ndalet gjithashtu në problematikën e kthimit të ekstremistëve shqiptarë dhe në procesin ri-integrimit dhe de-radikalizimit të tyre, duke shqyrtuar hapat e mundshëm në këtë drejtim.

Sa i takon reagimit, ky studim paraqet gjithashtu reagimin shtetëror dhe atë shoqëror ndaj fenomenit, duke analizuar hapat politikë, ligjorë dhe strategjikë të autoriteteve shqiptare, për t'u ndalur edhe tek reagimi i institucioneve dhe aktorëve shoqërorë. Duke qenë se shteti mban barrën kryesore të përballjes me këtë fenomen që mund të çënojë themelet e sigurisë kombëtare, shqyrtohen imtësisht ndryshimet e kuadrit ligjor e institucional, si dhe strategjitë e ndryshme të qeverisë shqiptare për t'u përballur me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin fetar. Së fundi, ky studim ofron disa rekomandime për politikëbërësit, aktorët kyçë institucionalë dhe shoqërinë civile, në formën e praktikave më efikase të përballjes me këtë sfidë të shumëfishtë sigurie.

## **2. Konteksti global dhe rajonal**

Ndër kërcënimet më të mëdha të sigurisë ndërkombëtare pas Luftës së Ftohtë radhiten terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm (me natyrë fetare) dhe radikalizmi islamik. Ndonëse këto fenomene u intensifikuan në fillim të viteve 1990-të, studimi i tyre u bë më sistematik vetëm pas vitit 2001 dhe sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara. Sulmet

terroriste të lidhura me organizata terroriste si ISIS, janë bërë më të shpeshta gjatë dy-tre viteve të fundit në Evropë (si ato më të fundit në Paris, më 13 nëntor 2015) por edhe të rajonit të Ballkanit (siç ishte rasti më i fundit në Bosnjë, më 19 nëntor 2015). Ato e bëjnë edhe më të rëndësishme për sigurinë kombëtare, rajonale dhe globale studimin e ekstremizmit fetar dhe terrorizmit të lidhur me të.

Hulumtimi i tyre kërkon të analizohet raporti mes përdorimit të dhunës nga shteti (si aktori që zotëron monopolin e saj) dhe aktorët joshitetërorë. Për të legjitimuar aktet e tyre, ekstremistët kërkojnë strehë brenda ideologjive, sidomos doktrinafe fetare. Përgjatë viteve 2000, kur përhapja e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar kishte marrë përmasa thuajse globale, vëmendja e studiuesve u përqendrua tek organizatat terroriste dhe ekstremiste me natyrë fetare, si aktorë joshitetërorë që kërcënonin jo vetëm sigurinë e shteteve por edhe atë rajonale e ndërkombëtare.

Fillimisht, konflikti në Siri erdhi si pasojë e kryengritjes siriane, në vazhden e kryengritjeve të Pranverës Arabe për të larguar regjimin diktatorial të Assad-it. Edhe pse konflikti filloi si kryengritje e popullit kundër regjimit, rrugës ai u shndërrua në përplasje mes regjimit dhe grupeve të ndryshme rebele. Kjo krijoi terrenin e favorshëm për përfshirjen e një numri në rritje luftëtarësh të huaj dhe organizatash terroriste, që e panë si mundësi të mirë për të fituar akses në një hapësirë të konsiderueshme gjeografike me rëndësi strategjike për Lindjen e Mesme. Organizata kryesore terroriste që u angazhua ishte ISIL, (*Islamic State of Iraq and Levant*) e cila integroi brenda saj disa organizata të tjera më të vogla, me objektiv kryesor themelimin e një Shteti Islamik në Irak dhe Siri. Me zgjerimin dhe konsolidimin e kontrollit të tyre në territoret e Sirisë dhe Irakut, si dhe krijimin e disa strukturave embrionale shtetërore, rekrutimi i vullnetarëve të rinj po bëhej gjithnjë e më i nevojshëm. Përveç kësaj kapacitetet financiare të organizatës morën përmasa të konsiderueshme, duke shfrytëzuar sidomos pasuritë e naftës, por edhe grabitjet, pengmarrjet dhe veprime të tjera kriminale.<sup>1</sup> Kjo e orientoi një pjesë të strategjisë së ISIL-it drejt krijimit të rrjeteve rajonale dhe globale të rekrutimit, jo vetëm nga Lindja e Mesme, por nga e gjithë bota. Këtu sigurisht nuk mund të bënte përjashtim as Ballkani, një terren preferencial për shkak të numrit të lartë të popullsisë myslimane në

---

<sup>1</sup> Shatz, H. (2014, 8 shtator). *How ISIS Funds its Reign of Terror*. US: Rand Corporation. <http://www.rand.org/blog/2014/09/how-isis-funds-its-reign-of-terror.html> (10/07/2015).

shumë prej vendeve, afërsisë gjeografike dhe ngjarjeve që pasuan fundin e Luftës së Ftohtë dhe konfliktet etnike, që në disa momente specifike morën edhe ngjyresa fetare, duke lehtësuar penetrimin e ideologjive dhe doktrinave radikale nga Lindja e Mesme.

Numri i luftëtarëve të huaj të angazhuar në konflikt në radhët e ekstremistëve të dhunshëm islamikë ka ardhur duke u rritur në mënyrë graduale gjatë viteve 2011-2015. Raportimet nga burime të ndryshme variojnë së tepërmi, nga rreth 12.000 në 54.000 luftëtarë të huaj. Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizmit (ICSR) me qendër në Londër, sugjeron se numri total i luftëtarëve të huaj në Siri llogaritet aktualisht në rreth 11.000-12.000 individë dhe vetëm 3.000 vijnë nga shtete perëndimore. Ndërkohë numri total i shteteve të origjinës është aktualisht mbi 80.<sup>2</sup> Ndërsa nëse u referohemi burimeve zyrtare të vendeve perëndimore, shifra aktuale vërtitet midis 20.000-30.000 luftëtarë të huaj.<sup>3</sup> Ndonëse shpërndarja gjeografike përfshin gjithë kontinentin evropian, vende si Gjermania, Britania e Madhe, Belgjika dhe Franca kanë numrin më të lartë të qytetarëve të tyre të angazhuar, llogaritur edhe si përqindje ndaj popullsisë së përgjithshme. Përveç vendeve perëndimore, një numër i konsiderueshëm luftëtarësh të huaj janë përfshirë në konflikt edhe nga vendet e Ballkanit (si Kosova, Maqedonia, Shqipëria, Serbia, Mali i Zi), duke i shtuar një dimension më të theksuar fetar çështjeve etnike që kanë problematizuar Ballkanin gjatë njëzetepesë viteve të kaluara.

Numri i luftëtarëve të huaj nga Ballkani përlllogaritet rreth 700–1,000 individë,<sup>4</sup> ku pjesën më të madhe e zënë qytetarët nga Bosnjë-Hercegovina, numri i të cilëve përlllogaritet në rreth 220-230 individë.<sup>5</sup> Megjithatë kjo është një shifër e kontestuar nga disa burime të tjera. Sipas një raporti të vitit 2014 të Agjencisë Qendrore të Inteligjencës në SHBA (CIA) numri i qytetarëve shqiptarë të angazhuar në Siri dhe Irak është rreth 140-150, i qytetarëve të Kosovës 150, Bosnjës 350, Maqedonisë 20, Malit të Zi 30 dhe

---

<sup>2</sup> <http://soufangroup.com/foreign-fighters-in-syria/> - 22/07/2015. Ndërsa sipas një raporti të publikuar nga ushtria siriane, që prej fillimit të luftës civile janë përfshirë rreth 54.000 luftëtarë të huaj nga 87 vende të ndryshme (pjesa më e madhe çeçenë, rreth 14.000, sauditë, rreth 12.000, libanezë, rreth 9.000, etj.) (<http://www.bbc.com/news/world-middle-east-29043331> - 09/07/2015).

<sup>3</sup> Byman, D. & Shapiro, J. (2014, Nëntor). *Be Afraid. Be a Little Afraid. The Threat of Terrorism from Western Foreign Fighters in Syria and Iraq*. Policy Paper No. 34, Foreign Policy Series, Washington D.C: Brookings Institution, Tab. 2, f. 11.

<sup>4</sup> Ky numër rezulton nga kryqëzimi dhe ballafaqimi i disa burimeve, si ICSR, CTC (Combating Terrorism Centre), CRS (Congressional Research Service), me shifrat zyrtare të shteteve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, Maqedoninë, Kosovën, Serbinë dhe Malin e Zi.

<sup>5</sup> Azinovic, V. & Jusic, M. (2015). *The Lure of the Syrian War: The Foreign Fighters' Bosnian Contingent*. Atlantic Initiative, Sarajevë, f. 30.



Serbisë 3 (në total rreth 690 individë).<sup>6</sup> Ndërsa sipas ministrit të punëve të brendshme të Kosovës, në fund të shkurtit 2015, numri i luftëtarëve të huaj nga Kosova llogaritej rreth 300.<sup>7</sup> Sipas Peter Newman nga ICSR, në janar 2015, numri i qytetarëve shqiptarë të përfshirë në luftime në Siri dhe Irak arrinte në rreth 90 individë.<sup>8</sup> Kurse qendra prestigjioze kërkimore amerikane Rand Corporation arrin në përfundimin se për vitin 2014 numri i luftëtarëve të huaj nga Shqipëria në Siri ishte midis 145-150 individë.<sup>9</sup> Siç do të analizohet në vijim të këtij studimi, referuar edhe burimeve zyrtare shqiptare, (të paktën deri në korrik të vitit 2015), shifra zyrtare e shtetasve shqiptarë të përfshirë në luftime në Siri dhe Irak, është 114 individë. Ndërkaq në rajonin e Ballkanit janë ndërmarrë disa studime mbi këtë fenomen, sidomos në rastin e Kosovës dhe Bosnjës, të cilat arrijnë në përfundimin e përbashkët se numri i luftëtarëve të huaj nga rajoni është rritur në intensitet sidomos gjatë vitit 2013 dhe 2014, ndërsa ka pësuar rënie të konsiderueshme gjatë gjysmës së parë të vitit 2015.<sup>10</sup>

*Grafiku 1: Numri i luftëtarëve të huaj në Siri dhe Irak (deri në fillim të vitit 2015)*

---


<sup>6</sup> Megjithatë studimi nuk specifikon nëse ky numër përfaqëson vetëm luftëtarët, apo edhe familjet e tyre. Cituar tek Bardon, G. (2015). *ISIS Balkan Networks*, American Centre for Democracy, Working Paper. <http://acdemocracy.org/isis-balkan-networks> - 04/07/2015. I njëjti numër raportohet edhe nga Washington Post, referuar burimeve të inteligjencës amerikane. "Foreign Fighters Flow to Syria," Washington Post, 11 Tetor, 2014.

<sup>7</sup> VOA (2015, 20 shkurt). Intervistë me Skënder Hysenin, Ministër i Brendshëm i Kosovës. Cituar tek Shtuni, A. (2015, Prill). *Albanian Foreign Fighters in Syria and Iraq*. CTC Sentinel, Vol. 8, Nr. 4, f. 12.

<sup>8</sup> Neuman, P. (2015) *Foreign Fighter Total in Syria/Iraq now exceeds 20,000*, në <http://icsr.info/2015/01/foreign-fighter-total-syriairaq-now-exceeds-20000-surpasses-afghanistan-conflict-1980s> - 02/07/2015).

<sup>9</sup> Jenkins, B. M. (2015). *When Jihadis Come Marching Home. The Terrorist Threat Posed by Westerns Returning from Syria and Iraq*. Perspectives, 130-1-RC, f. 35.

<sup>10</sup> Shih Azinovic, V. & Jusic, M. (2015), *ibid*, f. 32.



Për shkak të dinamikës komplekse të këtij fenomeni, është e vështirë të identifikohet numri i saktë ose i përafërt i luftëtarëve të huaj dhe të paraqiten evidenca të sakta të tyre. Luhatjet e këtyre shifrave u atribuohen kryesisht tre faktorëve: përfshirjes në këtë numër edhe të familjarëve, që do të analizohet në vijim të studimit; lëvizjeve dinamike, kthimit dhe vdekjeve/plagosjeve eventuale në konflikt; si dhe pjesëmarrjes më të gjerë të diasporës shqiptare nga Evropa Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara.<sup>11</sup>

Por megjithë vështirësinë për të siguruar të dhëna të sakta për numrin e luftëtarëve të huaj në Siri dhe Irak, pjesëmarrja e tyre masive nxjerr në pah lehtësinë e madhe me të cilën xhihadistët mund të zhvendosen drejt zonave të konfliktit. Turqia shërben si portë kryesore hyrëse për shumicën e luftëtarëve të huaj, në veçanti për ata që vijnë nga Ballkani Perëndimor.<sup>12</sup> Turqia Lindore, përfshirë qytetet Antakya dhe Kilis, shërben si nyja ndërlidhëse jo vetëm për luftëtarët e huaj por edhe për armët, paratë dhe furnizimet e tjera. Shumica e ekstremistëve kanë hyrë në Turqi nga ajri, kryesisht nëpërmjet aeroportit të Stambollit, ndonëse itineraret përfshijnë edhe transportin tokësor.<sup>13</sup> Arsyja kryesore

<sup>11</sup> Burimet e konsultuara për këtë studim nga shërbimet e inteligjencës, pohojnë se është shumë e vështirë të përcaktohet numri i saktë i shqiptarëve, për shkak të këtyre tre faktorëve.

<sup>12</sup> Shih Byman, D. & Shapiro, J. (2014, Nëntor). *Be Afraid. Be a Little Afraid. The Threat of Terrorism from Western Foreign Fighters in Syria and Iraq*. Policy Paper No. 34, Foreign Policy Series, Brookings Institution, f. 10.

<sup>13</sup> Siç pasqyron gazeta Today's Zaman në një artikull të saj të 06 shtatorit 2014.

[http://www.todayszaman.com/anasayfa\\_turkey-main-transit-route-for-balkan-fighters-to-syria-iraq\\_357854.html](http://www.todayszaman.com/anasayfa_turkey-main-transit-route-for-balkan-fighters-to-syria-iraq_357854.html) (10/05/2015).

është se nuk ka nevojë për t'u pajisur me vizë për qytetarët e këtyre shteteve. Gjithashtu ky itinerar ka kosto më të ulët dhe mund të financohet lehtësisht, duke mundësuar kësisoj edhe marrjen e familjarëve pasi nuk ka nevojë për infrastrukturë lehtësuese për të mbërritur deri në kufirin e Turqisë me Sirinë, i cili është rreth 900 i gjatë. Transiti nëpër Turqi, duke qenë në rrugë tokësore, e bën më të vështirë identifikimin nga autoritetet e sigurisë dhe të inteligjencës. Ndërsa nga ana siriane e kufirit tabloja plotësohet nga grupet rebele, që kontrollojnë shumë prej nyjeve dhe pikëkalimeve kufitare.

Ndërkaq, reagimi ndaj fenomenit jo vetëm në nivel politik, por edhe strategjik e ushtarak, ka qenë i shumanshëm. Ai ka përfshirë veprimtari ushtarake kundër ekstremistëve në territoret e tyre në Siri dhe Irak, forcimin e koordinimit dhe bashkëpunimit midis shteteve perëndimore, sidomos në Bashkimin Evropian, si dhe masa juridike brenda shumë vendeve. Por masat kanë qenë shumë më intensive në nivelin e BE-së, duke adresuar kryesisht hendekun juridik të trajtimit të këtyre individëve dhe shkëmbimin e informacionit për këta individë mes vendeve anëtare dhe kërcënimet potenciale që burojnë nga veprimtaria e tyre. Po ashtu, politikat e reagimit janë aktualisht në procesin e hartimit dhe implementimit të programeve të para të de-radikalizimit, të cilat pritet t'i japin frytet e tyre brenda disa vitesh. Në këtë kuadër, reagimi i vendeve të Ballkanit, siç do të shohim në vijim në rastin e Shqipërisë, ka qenë në drejtim të miratimit të masave ligjore, të koordinimit me shtetet e tjera të rajonit dhe të hartimit e implementimit të strategjive konkrete për t'u përballur me këtë rrezik relativisht të ri për rajonin.

### **3. Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi islamik në Shqipëri**

Ndonëse në fazë embrionale, shfaqja e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar në Shqipëri, kërkon vëmendje më të madhe nga të gjithë aktorët e sigurisë. Zgjerimi i influencës së tyre, sidomos me rekrutimin dhe përfshirjen e qytetarëve shqiptarë në Irak dhe Siri, për të luftuar nën ombrellën e ISIL dhe Al Nusra-s, dy organizatave terroriste, përbën jo vetëm kërcënim potencial të sigurisë kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, por përmban edhe rrezikun e cënimit të harmonisë fetare, çka do të ishte fatale për sigurinë, stabilitetin, madje edhe për të ardhmen e vendit.

Ky është një fenomen i importuar në Shqipëri dhe i kultivuar gjatë viteve të fundit, duke pasur parasysh jo vetëm harmoninë shumëvjeçare fetare në vend, por edhe një sërë kushtesh dhe faktorësh që do të trajtohen në thellësi në vijim. Raportimet e para për pjesëmarrjen e qytetarëve shqiptarë fillojnë në vitin 2012, ndërsa intensiteti i lëvizjes së ekstremistëve shqiptarë ka kulmuar në vitin 2014. Siç u konstatua edhe më lart, shifrat e qytetarëve shqiptarë të angazhuar në konflikt luhaten, sipas burimeve të ndryshme, nga 90-150 individë. Por raportimet shpeshherë nuk përfshijnë në to numrin e familjarëve që udhëtojnë bashkë me ekstremistët në zonën e luftimeve, të cilat në rastin e Shqipërisë janë rreth 31 fëmijë dhe 13 gra. Numri i të kthyerve raportohet zyrtarisht në rreth 45 individë, ndërsa 20 të tjerë kanë mbetur të vrarë në luftime dhe 10 të tjerë të plagosur.<sup>14</sup> Autoritetet shqiptare kanë arrestuar deri tani 15 individë me akuzën e nxitjes së ekstremizmit dhe terrorizmit, ndërsa 6 të tjerë janë shpallur në kërkim. Ndërkaq, të paktën deri në mesin e nëntorit të vitit 2015, një numri të konsiderueshëm individësh (rreth 20 të tillë) raportohet se u është mohuar hyrja në territorin shqiptar, për arsye që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin fetar.

Midis të arrestuarve janë edhe dy imamë të vetëshpallur, gjyqi i të cilëve është aktualisht në proces, ndërsa në sallën e gjyqit ata kanë refuzuar disa herë të njohin drejtësinë shqiptare si instancë, duke vetëshpallur Sheriatin (Ligjin Islamik) si të vetmin autoritet prej të cilit presin drejtësi. Nga pikëpamja gjeografike, harta e shfaqjes së këtij fenomeni përfshin rajone si Pogradeci, Elbasani, Librazhdi, Bulqiza, Cërriku, Kukësi dhe Dibra, sidomos zonat e thella rurale përreth këtyre qendrave urbane, apo edhe periferi të qyteteve të mëdha, si Tirana apo Durrësi.

### *3.1. Feja, shoqëria dhe politika në Shqipëri*

Sot Ballkani është një hapësirë ku jeton një pjesë e madhe e popullsisë myslimane të Evropës, me traditë disa-shekullore të islamit të moderuar, e cila daton që prej pushtimit osman të gadishullit në shekullin e pesëmbëdhjetë. Megjithatë zhvillimi i doktrinave fetare ka qenë i ndryshëm, në varësi të historisë së secilit prej vendeve dhe

---

<sup>14</sup> Shifrat janë përditësuar deri në gjysmën e dytë të nëntorit të vitit 2015, ndonëse duhet pranuar se janë në ndryshim të vazhdueshëm.

raportit që feja, sidomos ajo myslimane, ka krijuar me shtetin. Në disa vende të Ballkanit feja (si e krishterë ashtu dhe myslimane) ka luajtur historikisht rol thelbësor në formësimin e identiteteve kombëtare dhe konsolidimin e disa prej shteteve të rajonit. Në disa të tjera, për shkak edhe të sistemeve komuniste që u instaluan në rajon, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, feja humbi rëndësinë e saj, për t'u zbehur thuajse krejtësisht, si në rastin e Shqipërisë.

Në Shqipëri, për shkak të përbërjes shumëfetare të shoqërisë, feja nuk pati rol kyç në ndërtimin e kombit dhe të shtetit. Që në ngjizjen e identitetit shqiptar, përplasjet fetare janë zëvendësuar nga harmonia dhe bashkëjetesa ndërfitare, duke mos u shndërruar asnjëherë në problem të sigurisë kombëtare. Besimi fetar nuk ka qenë komponent përcaktues i identitetit kombëtar. Historikisht feja në Shqipëri nuk ka shërbyer si ideologji organizuese e shtetit, kombit apo shoqërisë.<sup>15</sup>

Por regjimi komunist, i cili e konsideronte çdo formë besimi fetar të papajtueshme me ideologjinë komuniste, e pa fenë si kërcënim për ekzistencën e tij, duke ndaluar të gjitha praktikat fetare. Ndalimi i besimit fetar dhe shkatërrimi i institucioneve fetare ishte një proces që shkoi paralel me izolimin e vendit. Në përpjekje për të konsoliduar pushtetin e tyre, komunistët sapo erdhën në pushtet ndërmorën një fushatë persekutimesh të ashpra ndaj klerikëve shqiptarë, duke i shpallur ata tradhtarë si bashkëpunëtorë të fashizmit.<sup>16</sup> Në vitet që pasuan, të nxitur edhe nga fryma e revolucionit kulturor kinez, institucionet fetare shqiptare u shkatërruan ose u shndërruan në qendra të propagandës së regjimit të ri. Shumica dërrmuese e rreth 1.200 xhamive dhe 400 kishave katolike e ortodokse u rrënuan ose u shndërruan në magazina, salla sporti ose kinema, ndërsa klerikët u persekutuan egërsisht ose u burgosën nëpër kampet e punës së detyruar. Ndryshe nga shumica e vendeve të tjera të Lindjes komuniste, regjimi diktatorial në Shqipëri i shpalli të jashtëligjshme të gjitha besimet fetare, duke u bërë shteti i parë ateist në botë. Regjimi arriti në një kohë relativisht të shpejtë të eliminonte besimin fetar dhe institucionet përkatëse, duke i parë ato si qendër potenciale rivalizuese pushteti.

### *3.2. Tranzicioni, demokratizimi dhe radikalizmi fetar*

---

<sup>15</sup> Rakipi, A. (2015, 21 Mars). *Lindja e një ndikimi të ri radikal në Shqipëri*. Gazeta Mapo. <http://www.mapo.al/2015/03/lindja-e-nje-ndikimi-te-ri-radikal-fetar-ne-shqiperi> (22/06/2015).

<sup>16</sup> Rakipi, A. (2015). Ibid.


Për të kuptuar procesin e sotëm të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar është e rëndësishme të bëhet fillimisht një përjasje historiko-politike e tranzicionit shqiptar, sidomos sa i takon rolit të fesë në shoqërinë dhe politikën shqiptare. Analiza në vijim shërben si një kontekst i nevojshëm për të kuptuar deformimin e mëpasshëm të sjelljes fetare të një segmenti shumë të vogël të komunitetit mysliman, drejt prirjeve më radikale, apo ekstremizmit potencialisht të dhunshëm, siç dëshmon pjesëmarrja e qytetarëve shqiptarë si Luftëtarë të Huaj gjatë 2-3 viteve të fundit në konfliktet në Siri dhe Irak. Procesi aktual i sigurizimit të fesë në debatin publik dhe politik, duke e shndërruar atë në problem potencial të sigurisë kombëtare, imponon edhe shqyrtimin e rolit të saj, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit post-komunist.

Rënia e regjimit komunist në vitin 1990 e zbuloi këtë trashëgimi ekstreme në çështjet e lirisë fetare në Shqipëri, duke nxjerr në pah një dinamikë tjetër, sa politike aq edhe ideologjike në raport me besimin fetar. Gjatë dy dekadave e gjysëm që pasuan, liritë dhe institucionet fetare janë zhvilluar në një kontekst shumë dinamik të transformimit politik, ekonomik dhe shoqëror. Shteti shqiptar u rindërtua nga themelet, ndërsa tranzicioni drejt sistemit demokratik rezultoi i gjatë dhe me kosto të larta, sidomos në rindërtimin e raporteve midis shoqërisë dhe shtetit. Ringjallja dhe rikthimi i lirive fetare gjatë njëzetepesë viteve të fundit evoluoi paralelisht me thyerjen e izolimit dhe hapjen e shpejtë të Shqipërisë drejt Perëndimit. Zhvillimi i lirive fetare, rindërtimi i institucionit të besimit, kulturës dhe praktikimit të fesë është një proces që vijon, sikundër i gjithë procesi i transformimit politik, ekonomik dhe i modernizimit të shoqërisë shqiptare.

Aktualisht, sipas të dhënave të sondazhit kombëtar të realizuar nga AIIS gjatë periudhës mars-prill 2015, rezulton se është rritur në nivele të konsiderueshme numri i shqiptarëve që praktikojnë fenë, duke pasur si pikënisje ateizmin total të periudhës komuniste. Kështu, ndonëse numri i praktikantëve (i kuptuar si praktikim i riteve fetare çdo ditë ose disa herë në ditë) është rreth 21.4%, të dhënat tregojnë se rreth një e katërta e shqiptarëve nuk e praktikojnë atë asnjëherë (23.6 %). Ndërsa më shumë se gjysma e tyre (rreth 53 %) e praktikojnë atë vetëm në kuptimin celebrativ, gjatë disa prej festave kryesore, pavarësisht nëse i përkasin ose jo komunitetit të caktuar fetar (*Grafiku 2*).

Kështu, në këtë aspekt “praktikimi i fesë” rezulton krejtësisht sipërfaqësor dhe jo thelbësor.

Grafiku 2: Sa shpesh praktikohet feja në Shqipëri – AIIS, 2015




Zhvillimi i lirive dhe institucioneve fetare është influencuar thellësisht nga procesi politik, ekonomik dhe shoqëror i tranzicionit postkomunist. Por procesi i ndërtimit dhe konsolidimit të tyre u vendos thelbësisht nën ndikimin e faktorëve të jashtëm. Sidomos gjatë viteve të para pas rënies së regjimit komunist ky ndikim u bë i dukshëm për disa arsye: i) për shkak të pamundësisë financiare të shtetit shqiptar për të mbështetur riorganizimin dhe mirë-funksionimin e institucioneve fetare; ii) për shkak të mungesës së vizionit politik për të kuptuar rëndësinë kyçe të institucioneve fetare gjatë tranzicionit dhe demokratizimit; si dhe iii) për shkak të paaftësisë për të ndërtuar një kuadër të plotë ligjor për funksionimin e këtyre institucioneve. Faktorët e jashtëm që kishin peshën kryesore brenda institucioneve fetare ishin të shumëllojshëm, që nga institucione homologe fetare të vendeve të tjera, shtete, organizata, etj. Brenda vendit kjo situatë u ndërthur me vakuumin e institucioneve të sigurisë dhe të zbatimit të ligjit, ndërsa jashtë tij me fuqizimin e lëvizjeve ekstremiste ndërkombëtare dhe radikalizmin islamik, me lidhje të forta me terrorizmin ndërkombëtar<sup>17</sup>. Siç do të konstatojmë edhe në vijim të këtij studimi, kjo krijoi gradualisht kushtet për penetrimin në vend të aktorëve dhe organizatave problematike. Ato do të shndërroheshin në vitet pasardhëse në sfida për sigurinë kombëtare të Shqipërisë.<sup>18</sup>

<sup>17</sup> Për më shume detaje shiko Rakipi, A. (2015). Ibid.

<sup>18</sup> Per një studim të posaçëm të çështjeve të sigurisë që lidhen me fenë shiko Bumçi, A. (2004). *Çështje të Sigurisë Kombëtare. Rasti i Shqipërisë. Kufiri, feja, korrupsioni*. Tiranë: AIIS Press.

Përpjekjet për zhvillimin dhe modernizimin e fesë islame kanë qenë hera-herës të debatueshme dhe problematike. Një arsye duhet kërkuar tek fakti që vetë kjo doktrinë fetare në rrafsh ndërkombëtar është në proces tranzicioni, reformimi dhe modernizimi, përballë tendencave të radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm. Në Shqipëri, ringjallja e besimit mysliman dhe rindërtimit të institucioneve përkatëse është mbështetur tek veçoria themelore e bashkëjetesës dhe harmonisë me besimet e tjera. Kjo mbështetet edhe tek perceptimi i opinionit publik, 84.3% e të cilit mendon se në Shqipëri ka harmoni fetare (*Grafiku 3*).

*Grafiku 3: Perceptimi publik rreth harmonisë fetare – AIIS, 2015*




Por, siç tregon eksperiencia e fillimviteve 1990-të, procesi nuk ka qenë i imunizuar nga penetrimi i tendencave radikale dhe ekstremiste. Ndonëse të dhënat më të fundit nga sondazhi i AIIS (*Grafiku 4*) tregojnë se shqiptarët kanë njohuri të kufizuara mbi fenë myslimane (77.7% e tyre deklarojnë se kanë pak ose asnjë njohuri rreth saj), radikalizmi islamik ka gjetur terren të përshtatshëm për një sërë faktorësh, që do të pasqyrohen në vijim.

*Grafiku 4: Njohuritë e publikut rreth fesë islame – AIIS, 2015*

---

Një problematikë e nxjerrë në pah në mënyrë konstante gjatë gjysmës së dytë të viteve 1990-të nga raportet e Kongresit dhe agjencive të inteligjencës së Shteteve të Bashkuara. Shih Woehrel, S. (2005). *Islamic Terrorism and the Balkans*. CRS Report for Congress, RL33012. <https://www.fas.org/sgp/crs/terror/RL33012.pdf> (11/04/2015).





Së pari, një faktor i rëndësishëm i periudhës postkomuniste ka qenë varfëria ekstreme e Shqipërisë postkomuniste dhe pamundësia e shtetit për të mbështetur procesin e rindërtimit të institucioneve fetare myslimane dhe funksionimin e tyre. Këto institucione jo vetëm ishin shkatërruar fizikisht, por edhe ishin zhveshur nga çdo element pronësie. Në këtë kontekst, një numër fondacionesh dhe organizatash, kryesisht nga Lindja e Mesme dhe Gjiri Persik, por jo vetëm, e mbushën këtë vakuum. Ato u përqendruan tek ndihmat materiale për rindërtimin dhe funksionimin e institucioneve fetare. Në shumicën dërrmuese të rasteve kjo mbartte koston e imponimit të një kulture të ndryshme myslimane prej asaj tradicionale shqiptare, traditës Hanefi.<sup>19</sup>

Së dyti, ringjallja e besimit fetar mysliman në Shqipëri ballafaqohej me nivelin e ulët të arsimit të klerit. Kjo kishte ardhur për shkak mungesës së theksuar të klerikëve myslimanë dhe pamundësisë së institucioneve arsimore fetare shqiptare për të përgatitur klerikët e ardhshëm. Një situatë e tillë krijoi terren tepër të favorshëm për shumë vende të Lindjes së Mesme (përfshirë edhe Turqinë) për t'u angazhuar në arsimimin e një kaste të re klerikësh dhe për të imponuar versione, doktrina dhe sekte të tjera, larg kulturës tradicionale myslimane shqiptare. Shkalla e influencës së këtyre dy faktorëve në deformimin e doktrinës tradicionale myslimane shqiptare është sigurisht e debatueshme, por nuk padryshim që këta kanë kontribuar në imponimin e një kulture tjetër fetare në Shqipëri.

<sup>19</sup> Siç pranon zyrtarisht edhe KMSH. Për më shumë detaje, shih Bumçi, A. (2004). *Çështje të Sigurisë Kombëtare. Rasti i Shqipërisë. Kufiri, feja, korrupsioni*. Tiranë: AIIS Press.

Në fakt edhe ata që e arsyetojnë bashkëjetesën fetare me argumentin se shqiptarët nuk janë besimtarë, edhe ata që pretendojnë se harmonia fetare është mit, nuk e kundërmojnë ekzistencën e saj, përderisa vështirë të gjendet gjatë viteve të fundit ndonjë episod konflikti fetar, urrejtjeje fetare, përçarjeje fetare, mobilizimi politik apo social me baza fetare.<sup>20</sup> Por bashkëjetesa dhe harmonia fetare, pavarësisht faktorëve që i kanë mundësuar, nuk mund të konsiderohen të mirëqena, të përhershme dhe të garantuara.

### 3.3. Përfshirja e shqiptarëve në Siri dhe Irak: fakte dhe numra

Përpara luftës civile në Siri dhe Irak, gjatë periudhës 2003-2011, numri i qytetarëve shqiptarë të përfshirë aktivisht në aktivitete xhihadiste ishte shumë i vogël. Aktivitetet xhihadiste nga Ballkani lidheshin thuajse tërësisht me shtetas boshnjakë.<sup>21</sup> Vëmendja sistematike e organizatave të specializuara shtetërore dhe aktorëve të tjerë të interesuar shqiptarë fillon të shfaqet rreth dy vite e gjysëm më parë, pasi lufta në Siri dhe në Irak kishte evoluar tashmë në një konflikt ku merrnin pjesë edhe luftëtarë të huaj, përfshirë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Por raportimet e para për ekstremistë shqiptarë që kanë udhëtuar drejt Sirisë e kanë zanafillën në vitin 2012. Ndërsa përfshirja e opinionit publik dhe medias shqiptare konstatohet sidomos pas disa sulmeve terroriste në fillim të vitit 2014, duke vërejtur praninë e shtuar dhe mjaft aktive në Siri të luftëtarëve të huaj me prejardhje nga Ballkani Perëndimor, kryesisht shqiptarë (nga të gjitha trevat dhe diaspora) dhe boshnjakë.<sup>22</sup> Këto raste dëshmojnë njëkohësisht për lidhjet midis celulave ekstremiste të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës Perëndimore. Fillimisht shumica dërrmuese e ekstremistëve shqiptarë iu bashkuan organizatës terroriste Jabhat al-Nusra,

---

<sup>20</sup> Rakipi, A. (2015, 21 Mars). *Lindja e një ndikimi të ri radikal në Shqipëri*. Gazeta Mapo. <http://www.mapo.al/2015/03/lindja-e-nje-ndikimi-te-ri-radikal-fetar-ne-shqiperi> (22/06/2015).

<sup>21</sup> Për një raport të plotë të rastit të luftëtarëve të huaj në Bosnjë-Hercegovinë, shih: Azinovic, V. & Jusic, M. (2015). *The Lure of the Syrian War: The Foreign Fighters' Bosnian Contingent*. Atlantic Initiative, Sarajevë. Përveç arrestimit të një shtetasi shqiptar nga autoritetet siriane në nëntor të vitit 2005 në Damask, si të dyshuar në përfshirjen në aktivitet terrorist ndërkombëtar, të gjitha raportimet e tjera rezultojnë të shtetasve boshnjakë. Raportohet gjithashtu se gjatë kësaj periudhe një numër i papërcaktuar boshnjakësh kanë udhëtuar në Jemen. Cituar tek Holman, T. (2014, June). *Foreign Fighters from the Western Balkans in Syria*. CTC Sentinel, Vol. 7, Nr. 6, f. 9.

<sup>22</sup> Siç rezultoi nga hetimet e mëvonshme këta individë i përkisnin diasporës së vendeve të rajonit. Dy prej tyre ishin qytetarë maqedonas, në emigracion, ndërsa një i tretë ishte kosovar që kishte jetuar prej vitesh në Zvicër. Holman, T. (2014, June). *Foreign Fighters from the Western Balkans in Syria*. CTC Sentinel, Vol. 7, Nr. 6, f. 8.

ndërsa një pjesë e vogël iu bashkuan ISIL-it, por ky raport është përmbysur me kalimin e kohës në favor të ISIL. Ekstremistët shqiptarë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia janë organizuar në Siri në një njësi të gjysëm-strukturuar dhe shumica e tyre i kanë deklaruar tashmë besnikërinë e tyre ISIL dhe liderit të tij.

Numri i luftëtarëve të huaj në Siri dhe Irak nga Shqipëria llogaritet midis 90-150 individë. Sipas burimeve zyrtare, numri i shtetasve shqiptarë të angazhuar në luftime në Siri dhe Irak është 114, ndërsa raportohet për rreth 40 individë të kthyer, ose afërsisht një e treta e xhihadistëve që i janë bashkuar luftës.<sup>23</sup> Raportimet tregojnë se fluksi i xhihadistëve nga Shqipëria që i janë bashkuar konfliktit ka ardhur në rritje në gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013 dhe gjysmës së parë të 2014, për të pësuar më pas rënie të konsiderueshme, duke shkuar pothuajse në zero gjatë gjysmës së parë të 2015, sipas burimeve zyrtare. Gjithsesi, kjo mbetet një çështje e debatueshme, për shkak të vështirësisë së identifikimit të lëvizjeve të eksponentëve ekstremistë, sa kohë që itinerari kryesor është ai tokësor nëpërmjet Turqisë, e cila nuk ka as sistem vizash me Shqipërinë, kurse daljet nga vendi janë si në rrugë tokësore, ashtu dhe ajrore. Në çdo rast, rënie që vërehet mund t'i atribuohet disa faktorëve, si arrestimit të disa imamëve dhe individëve të tjerë të angazhuar me dërgimin në Siri të ekstremistëve shqiptarë. Ajo mund t'i atribuohet gjithashtu intensifikimit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore, amplifikimit të çështjes në media dhe opinionin publik vendas.

Të dhënat tregojnë sakaq se ka ndryshuar edhe tendenca e ekstremistëve shqiptarë për t'iu bashkuar më shumë organizatës terroriste ISIL sesa Al-Nusra-s. Interesant mbetet fakti se përqindja e ekstremistëve islamikë shqiptarë që kanë marrë pjesë në Siri, në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë, rezulton shumë e lartë, krahasuar me vendet e tjera evropiane me popullsi më të madhe.<sup>24</sup> Ky raport shfaqet edhe më i përkeqësuar për Kosovën (me popullsi rreth 1.8 milionë banorë), nëse u referohemi shifrave zyrtare, sipas të cilave luftimeve u janë bashkuar rreth 300 ekstremistë.

Por ndër radhët e ekstremistëve shqiptarë që kanë marrë pjesë në luftime në Siri ka pasur edhe një numër viktimash. Sipas burimeve mediatike, deri në prill të vitit 2015,

---

<sup>23</sup> Të dhënat u referohen burimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme e Shqipërisë, dhe përfshijnë periudhën deri në 30 korrik 2015.

<sup>24</sup> "It Ain't Half Hot Here, Mom. Why and How Westerners go to Fight in Syria and Iraq", The Economist, 30 gusht 2014. <http://www.economist.com/news/middle-east-and-africa/21614226-why-and-how-westerners-go-to-fight-syria-and-iraq-it-aint-half-hot-here-mum> (28/06/2015).

numri i të vrarëve mes radhëve të xhihadistëve nga Shqipëria është 12.<sup>25</sup> Ndërsa sipas burimeve zyrtare gjatë konfliktit janë vrarë 18 xhihadistë shqiptarë, kurse numri i të plagosurve është 7 persona. Një pjesë e konsiderueshme e tyre, rreth 20-30 persona, kanë marrë trajnim ushtarak, të pjesshëm ose të plotë, në Shqipëri, ose në rajone të tjera.<sup>26</sup>

Sipas ministrisë së punëve të brendshme, deri në korrik 2015, në bashkëpunim me strukturat e tjera të anti-terrorit në policinë e shtetit dhe në shërbimet e inteligjencës ka ndërmarrë: i) tre operacione kundër grupeve që synonin të kryenin akte terroriste, duke ndaluar 14 persona, ndërsa 5 të tjerë janë shpallur në kërkim; ii) një operacion kundër grupeve terroriste, duke ndaluar 5 persona, ndërsa 2 janë shpallur në kërkim; iii) janë arrestuar 4 shtetas të tjerë, ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim, me akuzën për aktivitete terroriste; iv) me urdhër të gjykatave janë arrestuar 15 shtetas dhe janë shpallur në kërkim 6 të tjerë, me akuzat: “Rekrutim të personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste dhe financimin e terrorizmit” dhe “Nxitje, thirrje publike dhe propagandë për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”.

### 3.4. Gjeografia e fenomenit

Nga të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara për këtë studim ka rezultuar se numri më i madh i shtetasve shqiptarë të përfshirë në aktivitete terroriste në Siri dhe Irak vijnë nga komunitetet myslimane të disa rrethëve të Shqipërisë, si Pogradeci, Elbasani, Librazhdi, Bulqiza, Cërriku, Burreli, Kukësi dhe Dibra. Kjo shpërndarje gjeografike përkon me përqendrimin më të lartë të numrit të besimtarëve myslimanë. Në shumicën e tyre dërrmuese, këta individë vijnë nga zonat më të varfra rurale, krejtësisht të izoluara dhe të pazhvilluara. Nga kërkimi ka rezultuar se një pjesë e individëve vijnë edhe nga rrethinat e pazhvilluara të qyteteve të mëdha, si Tirana, Durrësi apo edhe Vlora.

---

<sup>25</sup> Shih mediat shqiptare të periudhës shtator-tetor 2014. <http://www.gazetatema.net/web/2014/09/14/ne-siri-dhe-irak-deri-tani-40-shqiptare-te-vrare/> (06/07/2015). Gjithashtu Holman, T. (2014, June). *Foreign Fighters from the Western Balkans in Syria*. CTC Sentinel, Vol. 7, Nr. 6, f. 8.

<sup>26</sup> Holman, T. (2014, June). *Foreign Fighters from the Western Balkans in Syria*. CTC Sentinel, Vol. 7, Nr. 6, f. 8. Sipas Adrian Shtunit, të paktën 14 ekstremistë shqiptarë, siç rezulton nga raportimet mediatike, kanë pasur trajnim të mëparshëm ushtarak, ndërsa 10 të tjerë kanë pasur trajnim fetar. Shtuni, A. (2015), *ibid.* f. 13. Ndërsa një raportim i gazetës Tema në mars të vitit 2014 bën fjalë për katër pjesëtarë të forcave speciale të ushtrisë shqiptare (trupave komando të Zallherit), që u janë bashkuar ekstremistëve në Siri, dy prej të cilëve kanë humbur jetën në luftime. Gazeta “Tema”, 21 Mars 2014.

### 3.5. Faktorët e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit islamik në Shqipëri

Për arsytet që u trajtuan më lart mbi harmoninë dhe bashkëjetesën fetare, radikalizmi islamik nuk përbën fenomen endogjen shqiptar. Ky fenomen ka dimension global dhe, përpara se të zhvillohej në Shqipëri, ai është një proces që ka ndodhur në shumë vende të tjera të botës, shumë prej të cilave vende me demokraci të konsoliduar dhe zhvillim ekonomik të madh. Përtej kësaj, shqiptarët nuk janë shtetasit e parë që janë përfshirë në luftime në Irak dhe Siri përkrah organizatave ekstremiste, si ISIL dhe Al Nusra, por fakti se një pjesë e konsiderueshme e luftëtarëve të huaj vijnë nga vende evropiane, mund të shërbejë si faktor nxitës edhe në Shqipëri.

Debatet në Shqipëri kanë qenë më shumë të natyrës teologjike, brenda të njëjtës traditë fetare myslimane shumë të moderuar. Pavarësisht kësaj, radikalizmi islamik ka mundur të penetrojë në mjedisin shqiptar për një sërë faktorësh, të cilët janë sa kulturorë, aq edhe arsimorë, socialë e ekonomikë. Ai ka penetruar historikisht përmes fondacioneve islamike, ndërsa aktualisht ushqehet prej celulave ekstremiste fetare, të cilat ndodhen jashtë kontrollit të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Ka shumë qasje të hulumtimit të radikalizmit islamik, të cilat u referohen shkaqeve të drejtpërdrejta, sipërfaqësore, precipituese, të thella, historike, etj. Megjithatë, për të kuptuar më qartë dhe në mënyrë më skematike arsytet e radikalizmit islamik në Shqipëri do të përdorim modelin analitik që ofrojnë studiuesit Veldhuis & Staun, sipas të cilëve, ato mund të grupohen në *shkaqe makro-nivelo*re dhe *shkaqe mikro-nivelo*re.<sup>27</sup>

Nga kërkimi në terren dhe intervistat e realizuara me ekspertë, pjesëtarë të komunitetit dhe drejtues të institucioneve kyçe, rezulton se pjesa më e madhe e qytetarëve shqiptarë që i janë bashkuar luftës në Siri dhe Irak kanë të përbashkët *marxhinalizimin dhe izolimin* nga pjesa tjetër e shoqërisë. Këta dy faktorë bëjnë që shpesh ekstremistët të jenë në kërkim të një qëllimi dhe kauze për jetën e tyre. Ky refuzim për të krijuar apo rivendosur ura komunikimi me pjesën tjetër të shoqërisë mund të interpretohet në disa mënyra. Së pari, si pasojë e hendeqeve të mëdha socio-ekonomike

---

<sup>27</sup> Veldhuis, T. & Staun, J. (2009, Tetor). *Islamist Radicalisation: A Root Cause Model*. Netherland Institute for International Relations, f. 21.

që ka prodhuar tranzicioni shqiptar. Së dyti, si problem komunikimi i institucioneve shtetërore, që kanë përgjegjësinë të krijojnë ura mirëkuptimi dhe përçimi të mesazheve të paqes nga shteti. Së treti, si dështim i KMSH-së për të vënë në kontroll të gjitha objektet e kultit. Së katërti, si një problem i vetë komuniteteve për të sinjalizuar në kohë përpjekjet për të krijuar grupe/celula të radikalizuara.

Një tjetër shkak është humbja e besimit *tek shteti ligjor*. Kjo e diferencon procesin e radikalizimit prej premisave mbi të cilat ai bazohet në Evropën Perëndimore, ku demokracia është e konsoliduar dhe radikalistët orientohen më shumë tek krahasimi i demokracisë me një sistem politik që ka në qendër ligjin islam. Procesi i ngadaltë dhe i vështirë i Shqipërisë drejt demokratizimit, dobësitë e shtetit shqiptar për të shpërndarë drejtësi dhe për të imponuar ligjet, niveli i lartë i korrupsionit por sidomos korrupsioni në drejtësi, mungesa e zgjidhjes së çështjes së pronave, niveli i lartë i kriminalitetit, dhe të gjitha problemet e tjera që lidhen me shtetin ligjor, janë përdorur nga ekstremistët për të radikalizuar një segment të vogël të myslimanëve shqiptarë, me argumentin se Islami është zgjidhja. Por mes tyre spikat mungesa e efikasitetit të drejtësisë problemi më i mprehtë që është përdorur për të radikalizuar, sidomos të rinjtë në Shqipëri. Sipas teologut Ermir Gjinishi, Ish-Zv/Kryetar i KMSH-së, kjo përbën keqinterpretim të doktrinës fetare, në funksion të objektivave politikë.<sup>28</sup> Ekstremistët i shfrytëzojnë dobësitë e shtetit dhe të institucioneve shqiptare për të refuzuar ekzistencën e të gjithë sistemit. Ata argumentojnë se ky vakum i shtetit ligjor, i cili duhet të mbushet me të ligjin islamik, ose “*Sheriatin*”. Por problemi me shtetin ligjor në Shqipëri janë zbatimet e ligjeve, jo mungesa e tyre, çka është përgjegjësi e të gjitha institucioneve që shpërndajnë drejtësi në vend. Pikërisht këtu duhen identifikuar edhe përpjekjet e segmenteve të caktuara brenda besimtarëve, për ta përdorur politikisht situatën, duke penetruar brenda sistemit politik standard shqiptar. Në vitin 2007 pa pasur përpjekje për të krijuar një parti politike islamike në Shqipëri, por kjo lëvizje nuk mori mbështetjen e KMSH-së dhe të komunitetit më të gjerë të besimtarëve, sikurse nuk u mbështet as nga elita kulturore dhe politike e vendit. Kjo përpjekje shënon rastin e parë për t’i dhënë ngjyrim politik një doktrine fetare në Shqipëri.

---

<sup>28</sup> Intervistë me teologun Ermir Gjinishi, ish nën-kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar me autorin, dt. 10 Korrik 2015.

Ndonëse përpjekja e radikalistëve islamikë për të krijuar një parti politike dhe për të penetruar brenda sistemit legal standard nuk ka asnjë shans suksesi, një tjetër pikëpyetje që ngrihet në lidhje me dinamikën më afatgjatë të procesit është *rritja e interesit të partive politike në fushata elektorale, duke u përpjekur të grumbullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë vota besimtarësh*. Një problematikë e tillë është ngritur gjatë viteve të fundit herë pas here nga partitë më të mëdha politike si akuza ndaj njëri-tjetrit, sa herë vendi ndodhet në prag zgjedhjesh lokale apo edhe qendrore, ndërsa shoqëria civile nuk ka reaguuar ende. Akuza të ashpra janë artikuluar edhe nga disa hoxhallarë të moderuar për përfshirje të KMSH-së në mbështetje të partive politike.<sup>29</sup> Kjo mund të krijojë premisat e fillimit të një lëvizjeje politike, duke përvijuar konturet e një partie të re politike.

Një tjetër shkak i radikalizmit islamik në Shqipëri lidhet me *diskriminimin fetar*. Ndonëse ai nuk një fenomen i hasur në Shqipëri, përveçse në raste shumë të rralla gjatë viteve të fundit, ai ka qenë një argument i përdorur gjerësisht nga radikalistët për të indoktrinuuar besimtarët. Por diskriminimi për shkak të besimit fetar mysliman nuk duhet ngatërruar me islamofobinë, një fenomen që nuk është shfaqur asnjëherë në Shqipëri. Për ta diferencuar atë prej paragjyqimeve/diskriminimeve fetare, sipas një studimi të universitetit Berkeley në SHBA: “islamofobia është frika ose paragjykimi i nxitur nga struktura aktuale perëndimore e pushtetit global. Ajo drejtohet kundër një kërcënimi të perceptuar mysliman duke zgjeruar pabarazitë ekzistuese në marrëdhëniet ekonomike, politike, shoqërore dhe kulturore”. E thënë ndryshe, islamofobia është armiqësia e pabazuar kundër myslimanëve dhe frika ose përçmimi i të gjithë komunitetit mysliman. Ky koncept është përdorur më shumë në perëndim, për të shpjeguar tjetërsimin e myslimanëve, sidomos gjatë dhe pas viteve 2000. Ky shpjegim i konceptit na shërben për të sqaruar se në Shqipëri, për shkak të harmonisë fetare nuk ekziston një çështje e tillë. Një prej mënyrave sesi diskriminimi mund të kapërcehet është e bërë atë pjesë të debatit publik.

---

<sup>29</sup> Kështu, në një intervistë për "Agon Channel" imami Neki Kaloshi deklaroi se dalja publikisht e disa përfaqësuesve të fesë në krah të kandidatëve, tregon krizën që ka përfshirë këtë komunitet me rryma të fshehta përkatësie politike. <http://agonchanneltv.com/category/video/page/13/lajme/lajme/page/3/> (16/06/2015)

Radikalizmi islamik në Shqipëri ka penetruar edhe për shkak se institucionet kryesore, si Shërbimi Informativ, organet ligjzbatuese dhe prokuroria që kanë ndjekur këtë çështje gjatë 5-7 viteve të fundit nuk kanë funksionuar për të marrë masat e duhura parandaluese. Nga ana tjetër, radikalizmi islamik është proces që kërkon një periudhë relativisht të gjatë kultivimi për të shfaqur impaktin e tij në sigurinë kombëtare. Si i tillë ai ka disa etapa, që do t'i analizojmë në vijim të këtij studimi. Masat që mund të merren për çdo fazë janë të ndryshme. Përveç instrumenteve të zbatimit të ligjit, institucionet e sigurisë kanë treguar mangësi të theksuara në njohjen e çështjes, impaktit dhe pasojave të saj. Kjo rezulton sidomos nga mungesa e reagimit të institucioneve gjatë viteve të kaluara ndaj nxitjes së urrejtjes fetare nëpërmjet predikimeve online, të cilat falë teknologjisë jo vetëm janë shtuar, por e kanë bërë edhe më të vështirë gjurmimin dhe parandalimin e tyre.

*Radikalizmi islamik në Shqipëri ka edhe shkaqe më thella socio-ekonomike.* Në fakt studiuesit ndahen në dy grupe të mëdha: në njërin grup radhiten ata që besojnë se rrënjët e thella të radikalizmit islamik lidhen me vështirësitë ekonomike, varfërinë dhe papunësinë, nivelin arsimor dhe kulturor në botën myslimane.<sup>30</sup> Ndërsa në grupin tjetër janë ata që besojnë se shkaqet nuk janë ekonomike dhe socio-kulturore.<sup>31</sup> Pavarësisht këtij konteksti teorik, duhet të kemi parasysh disa veçori të rastit shqiptar. Nga analiza e të dhënave për ekstremistët shqiptarë, rezulton se shumica e xhihadistëve shqiptarë vijnë nga zona rurale, të varfra ose shumë të varfra. Varfëria ekstreme e shoqëruar me mungesën e shtetit në këto rajone, kanë krijuar një vakuum zhvillimi dhe perspektive i cili është mbushur gradualisht nga aktorë të tjerë, si fondacionet islamike, apo duke lehtësuar penetrimin e ideve ekstremiste islamike. Sipas shifrave zyrtare, papunësia gjatë periudhës 2010-2015 luhetet nga rreth 18-21% e totalit të fuqisë punëtore, shifër e cila rritet edhe më shumë nëse i referohemi në mënyrë specifike rajoneve gjeografike prej nga vijnë shumica dërrmuese e ekstremistëve shqiptarë që luftojnë në Siri dhe Irak, si

---

<sup>30</sup> Të frymëzuar nga teoria e modernizimit, ata argumentojnë se radikalizmi islamik vjen si reagim politik ndaj thellimit të pabarazisë, vështirësive ekonomike dhe padijes me të cilat përballen myslimanët, për të cilat shkaktohet është Perëndimi dhe interesat ekonomike të elitës së botës myslimane. Shih Taspinar O. (2009, Verë). *Fighting Radicalism, not 'Terrorism': Roots Causes of an International Actor Redefined*. SAIS Review, Vol. XIX, No. 2, ff. 75-76.

<sup>31</sup> Kjo sepse kërkimet empirike kanë sugjeruar se një pjesë e konsiderueshme e ekstremistëve dhe terroristëve nuk janë as të varfër as të keqarsimuar, por janë më shumë arsye doktrinale dhe ideologjike. Barro, R. (2002, Qershor). *The Myth That Poverty Breeds Terrorism*. Business Week.




Pogradeci, Elbasani, Librazhdi, Bulqiza, Burreli, Dibra, etj.<sup>32</sup> Nga ana tjetër, sipas Indeksit të Zhvillimit Njerëzor, Shqipëria radhitet e 39-të në Evropë. Niveli i papunësisë për grupmoshën e re 17-35 vjeç, e cila është më e ekspozuar ndaj radikalizmit, është shumë i lartë, duke i kaluar në disa qarqe edhe mbi 40-45%.<sup>33</sup>

Por nëse pamundësia për të mbijetuar e krijon parakushtet e duhura për mercenarizmin fetar, *arsimimi i ulët* në këto zona periferike, të thella dhe të pazhvilluara, është katalizatori tjetër që lehtëson procesin e radikalizmit islamik. Mungesa e shanseve për arsim dhe analfabetizmi në zonat e thella, luan rol kyç në manipulimin fetar dhe ideologjik.

Sa i takon perceptimit publik të shkaqeve që nxisin këtë fenomen, ato lidhen natyrshëm me pritshmëritë e tyre për zgjidhjet e mundshme që mund të ndërmerren nga institucionet shtetërore, shoqëria civile apo edhe KMSH. Kështu, rezultatet e sondazhit lidhur me perceptimin e opinionit publik për shkaqet që kanë detyruar një numër qytetarësh shqiptarë të përfshihen në aktivitete ekstremiste, nxjerrin në pah varfërinë (41.3%) dhe arsyet financiare (21.1%) si shkaqet kryesore të angazhimit të tyre (ndërsa rreth 10% përmendin arsimimin dhe 12.6% ideologjinë fetare radikale) (*Grafiku 5*).

*Grafiku 5: Shkaqet e përfshirjes së qytetarëve shqiptarë në organizata ekstremiste*



Nga ana tjetër, një shkak i rritjes së numrit të ekstremistëve islamikë në Shqipëri dhe i aftësisë së radikalizmit islamik për të penetruar vitet e fundit brenda komunitetit

<sup>32</sup> Sipas të dhënave të INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-punës.aspx?tab=tabs-5> (30/06/2015).

<sup>33</sup> Sipas INSTAT, ibid.

musliman duke indoktrinuor një numër në rritje individësh, duhet kërkuar edhe tek *veprimet dhe sidomos mosveprimet e Komunitetit Mysliman Shqiptar*, si institucioni kryesor përgjegjës për aktivitetin fetar musliman në vend. Pavarësisht se xhamitë dhe objektet e tjera të kultit ku zhvillohet një pjesë e indoktrinimit radikalit nuk kanë qenë objekte në varësi të drejtpërdrejtë të tij, KMSH ka qenë pasiv vitet e mëparshme, kur fenomeni ishte ende në etapat e tij fillestare. Sipas të dhënave të siguruar për këtë studim, të kryqëzuara me të dhënat që vijnë nga burime zyrtare shtetërore dhe mediatike, janë një numër i vogël xhamish (7-10 të tilla) të cilat nuk janë brenda autoritetit të KMSH-së, nga rreth 450-500 objekte kulti në total. Zyrtarisht KMSH nuk përmend me saktësi numrin e xhamive jashtë administrimit të KMSH-së.<sup>34</sup> Bëhet fjalë për një numër të vogël xhamish, të cilat tashmë po synohet të kalojnë nën administrimin e KMSH-së, disa prej tyre kanë pranuar, disa të tjerë jo, duke e adresuar çështjen tek ligjet shqiptare për rregullimin e kësaj situate. Nga ana tjetër, siç e kemi përmendur edhe më lart, problematik mbetet radikalizimi apo gjuha ekstreme e urrejtjes e përdorur edhe nëpër një numër të vogël xhami zyrtare.

Bazuar në informacionet e grumbulluara mbi ekstremistët shqiptarë, moshë mesatare është rreth 31-35 vjeç, relativisht më e lartë se ajo e shqiptarëve të Kosovës, 21-25 vjeç.<sup>35</sup> Kjo provon së pari, se procesi i radikalizimit islamik në Shqipëri ka filluar rreth 5-8 vite më herët ngase në Kosovë, që në vitet e para pas viteve 1990 (1990-1995). Kjo do të thotë se penetrimi i ekstremistëve islamikë po i jep tashmë frytet e tij, pasi procesi fillon thuhet gjithnjë në moshë të hershme. Së dyti, kjo nxjerr në pah rëndësinë që ka media sociale dhe interneti në epokën e sotme si një nga hapësirat kryesore në të cilat kultivohet ekstremizmi fetar, sepse lehtësojnë jashtëzakonisht komunikimin dhe përçimin e mesazheve ekstremiste. Format e reja të socializimit të individëve po bëhen vendimtare në këtë proces, sidomos në radhët e të rinjve që ndjehen të marxhinalizuar dhe izoluar nga shoqëria, duke gjetur “strehim” tek përqaftimi i ideve ekstremiste islamike dhe përfshirja në luftime në Siri dhe Irak. Forumet e internetit dhe rrjetet sociale janë veçanërisht të suksesshëm si katalizatorë radikalizues, duke i vendosur në mënyrë konstante ekstremistët në Siri dhe Irak në kontakt me individë të gatshëm për t’iu

---

<sup>34</sup> Intervistë me zyrtarë të lartë të KMSH-së.

<sup>35</sup> Shtuni, A. (2015), *ibid.* f. 13.

bashkuar kauzës së tyre – edhe në Shqipëri. Sasia e informacionit dhe “trafik virtual” është praktikisht i pamundur të kontrollohet, çka e vështirëson jashtëzakonisht punën e agjencive të specializuara, edhe pse vitet e fundit janë ngritur struktura monitoruese të specializuara të teknologjisë së lartë.<sup>36</sup>

Nga ana tjetër, duke qenë një fenomen i importuar brenda besimtarëve myslimanë shqiptarë, radikalistët përdorin një sërë argumentesh edhe nga situata ndërkombëtare. Ndryshimet e të ashtuquajturës ‘Pranvera Arabe’ kanë nxitur dhe ushqyer radikalizmin në Shqipëri me premisën se, duke pasur parasysh kushtet e vështira socio-ekonomike dhe tranzicionin e vështirë dhe shumëvjeçar demokratik, myslimanët duhet të përqafonin islamin politik. Kjo vihet re tek predikimet shumë intensive gjatë këtyre viteve –hera-herës edhe brenda xhamive nën kontrollin e KMSH-së– mbi zhvillimet e fundit në Egjipt, Tunizi, Siri dhe në Lindjen e Mesme në përgjithësi. Nga ana tjetër, pjesë e diskursit ekstremist në Shqipëri, siç rezulton nga analiza e gjuhës së predikimeve,<sup>37</sup> ka qenë urrejtja kundër Perëndimit dhe sidomos kundër Shteteve të Bashkuara, i identifikuar si armiku më i madh, për shkak të padrejtësive të mëdha që po u bëhen vëllezërve myslimanë në Siri, Irak, etj. Kështu, ekstremistët e dhunshëm në Siri dhe Irak paraqiten si luftëtarë që kanë shkuar për të mbrojtur vëllezërit myslimanë dhe për të dhënë jetën për Allahun. Nga ana tjetër, ata i kundërvihen edhe myslimanëve të moderuar në Shqipëri, duke i qëndruar besnikë linjës tekfiriste, duke refuzuar haptazi demokracinë. Sipas dosjes së policisë në dy xhamitë ilegale ku predikonin Genci Balla dhe Bujar Hysa aktiviteti fetar shkonte paralelisht me atë ushtarak. Policia ka sekuestruar armë, fishekë, xhupa kamufllazhi, dylbi e objekte të tjera luftarakë në shtëpitë e bashkëpunëtorëve të tyre të ngushtë. Procesi gjyqësor përfshin në total nëntë imamë të Tiranës, të cilët akuzohen për nxitje të përfshirjes ose financimit të aktiviteteve terroriste, si edhe veprën penale të nxitjes së “urrejtjes dhe grindjes”.<sup>38</sup> Një pjesë të konsiderueshme të predikimeve

---

<sup>36</sup> Sipas disa vlerësimeve, ekzistojnë rreth 25.000 llogari virtuale në Twitter të ISIL të krijuara vetëm në fillim të vitit 2015, të cilat dërgojnë një mesatare prej rreth 200.000 mesazhesh çdo javë. <https://www.gov.uk/government/publications/the-use-of-social-media-for-online-radicalisation> (20/07/2015).

<sup>37</sup> Të shumta janë predikime të tilla nëpër forumet në internet të ekstremistëve shqiptarë, por edhe nëpërmjet videoeve që u drejtohen kryesisht të rinjve myslimanë.


<sup>38</sup> Kjo rezulton nga raportimet mediatike mbi predikimet ekstremiste të imamëve të arrestuar Genci (Abdurrahman) Balla dhe Bujar Hysa. <http://www.reporter.al/dosja-e-xhihadit-rol-i-imameve-ne-rekrutimin-e-militanteve-shqiptare/> (08/07/2015).

ekstremiste e zë edhe gjuha e urrejtjes ndaj Izraelit, duke shfaqur një anti-semitizëm të hapur, i cili nuk ka lidhje me historinë e komunitetit mysliman shqiptar.

Ndarja e faktorëve shkakësorë në nivel makro dhe mikro, na mundëson të diferencojmë më tej shkaqet e radikalizmit nga faktorët precipitues, që janë përgjegjës për përshpejtimin e befasishëm të procesit të radikalizmit (shih *Tabelën 1*). Kjo na ndihmon t'i kuptojmë këto fenomene që në gjenezë, duke përcaktuar më me saktësi shkallën e rrezikshmërisë së tyre dhe kërcënimin për sigurinë e komunitetit ku shfaqen dhe sigurinë kombëtare më në përgjithësi.

Kategorizimi i mësipërm i shkaqeve që shkaktojnë radikalizmin fetar, pasqyrohet në mënyrë më të përmblëdhur në *Tabelën 1* më poshtë.

*Tabela 1: Faktorët që shkaktojnë radikalizimin*



### 3.6. Procesi i radikalizmit: nevoja e një modeli

Si rrjedhojë e natyrës shumëdimensionale të shkaqeve të radikalizmit islamik, studiuesit kanë zhvilluar edhe një sërë modelesh konceptuale dhe empirike për ta kuptuar atë më mirë. Ndonëse literatura është mjaft e gjerë në këtë drejtim, për qëllimet e këtij studimi dhe duke pasur parasysh specifikat e rastit shqiptar të radikalizmit islamik, që përfshin një sërë parametrash të të ashtuquajturit “ekstremizëm terreni” (“*grassroot extremism*”), do të përdorim modelin e Veldhuis & Staun, të cilët e kanë zhvilluar atë për të kuptuar rrënjët e fenomenit si konceptualisht ashtu dhe empirikisht.<sup>40</sup> Ky model përshtatet më shumë me rastin e vendeve si Shqipëria, Kosova apo vendet e tjera të Ballkanit, krahasuar, për shembull, me modelin e FBI-së, të Departamentit të Policisë së Nju Jorkut apo Udhërrëfyesin e Nxitësve të Ekstremizmit të Dhunshëm të USAID.<sup>41</sup>

Një prej modeleve më të përhapura është i ashtuquajturit “*modeli nga lart-poshtë*” (ang. “*top-down*”), (shih *Tabelën 2*) i cili bën dallimin midis etapave të ndryshme të procesit të radikalizimit të një individi.

*Tabela 2: Modeli me disa etapa i procesit të radikalizmit islamik*

<b>Etapa 1</b>	<b>Etapa 2</b>	<b>Etapa 3</b>	<b>Etapa 4</b>
Vendosja e kontaktit midis “radikalizuesit” dhe një personi të hapur ndaj ideve radikale.	- Ndryshim gradual i sjelljes – ndryshim në sjelljen fetare. - Zakone/forma të reja komunikimi (kryesisht nëpërmjet internetit).	- Ndryshim i jetës sociale, duke u shoqëruar gjithnjë e më shumë me individë me mentalitet të ngjashëm. (Socializim) - Ndërprerje ose kufizim i lidhjeve shoqërore me familjen dhe miqtë e mëparshëm.	- Procesi i “kalitjes” morale, kryesisht duke parë video shumë të dhunshme dhe skena luftimi nga aktivitetet xhihadiste. - Largimi drejt zonave të luftimit

Burimi: Veldhuis, T. & Staun, J. (2009), f. 14.

<sup>39</sup> Veldhuis, T. & Staun, J. (2009, Tetor). *Islamist Radicalisation: A Root Cause Model*. Netherland Institute for International Relations, f. 23.

<sup>40</sup> Veldhuis, T. & Staun, J. (2009, Tetor). *Islamist Radicalisation: A Root Cause Model*. Netherland Institute for International Relations, ff. 14-18.

<sup>41</sup> Për modelin e radikalizmit të Policisë së Nju Jorkut dhe atij të FBI-së shih [http://www.nypdshield.org/public/SiteFiles/documents/NYPD\\_Report-Radicalization\\_in\\_the\\_West.pdf](http://www.nypdshield.org/public/SiteFiles/documents/NYPD_Report-Radicalization_in_the_West.pdf) (08/07/2015).

Procesi fillon me hapjen e një individi (“i radikalizuari”) ndaj ideve ekstremiste. Kryesisht kjo ndodh në moshat e reja, kur shkaqet që shpjeguan më lart, si varfëria, papunësia dhe mungesa e arsimit, e bëjnë dikë më vulnerabël dhe më të predispozuar ndaj ideve ekstreme fetare. Ky proces lehtësohet nga takimi i të radikalizuarit me një eksponent ekstremist, i emërtuar “radikalizuesi”, i cili nxit indoktrinimin e të radikalizuarit me praktika ekstreme fetare, duke ndryshuar sjelljen e tij. Në këtë fazë të parë ndodh edhe procesi i ideologjizimit me urrejtje ndaj gjithçkaje perëndimore, anti-semitizmi si dhe nxitja e urrejtjes ndaj myslimanëve të moderuar brenda vendit, të cilët janë bërë palë me armiqtë duke pranuar sistemin demokratik. Procesi vijon me socializimin e tij në mjedise virtuale ekstremiste, me individë të ngjashëm, jo vetëm nga vendi por nga e gjithë bota, ngushtimin e rrethit familjar dhe atij të miqve të të radikalizuarit dhe me kalitjen e tij morale, që përfshin familjarizimin me dhunën brutale (nëpërmjet videove dhe internetit) të terroristëve në betejë dhe masakrimin e pengjeve.

Forca më e madhe e këtij modeli është renditja e procesit të radikalizimit sipas etapave specifike, sepse kjo bën të mundur që për secilën prej të mund të hartohen strategji, plane veprimi apo masa parandaluese. Kështu për shembull, në fazën e parë është e mundur të fokusohemi në një strategji parandaluese mbi të ashtuquajturin “radikalizues” – ose ndryshe, tek imamët radikalë që synojnë të konvertojnë të rinjtë myslimanë nëpër xhami, në burgje, ose në qendra të tjera arsimimi/trajnimi fetar. Kështu për shembull, autoritetet mund të zgjedhin të rrisin monitorimin e imamëve radikalë, të kufizojnë lirinë e lëvizjes së tyre, të bindin institucionet fetare si KMSH për të informuar autoritetet për raste të tilla ose të zhvillojnë fushata ndërgjegjësimi me besimtarët myslimanë që frekuentojnë këto vende, në mënyrë që të nxisin një qasje më proaktive prej tyre. Në këtë fazë qeveria duhet të marrë masa për mbylljen e xhamive që nuk ndodhen nën kontrollin e KMSH-së, duke bërë ndoshta edhe ndryshimet e nevojshme ligjore për t’i shpallur ato të jashtëligjshme. Në fazën e dytë, autoritetet mund të përpiqen të identifikojnë individë të rinj që shfaqin “sjellje të ndryshuar”, duke i de-radikalizuar ata. Në këtë rast procesi i de-radikalizimit të individëve me bindje ekstremiste fetare ndodh përpara se ai të largohet drejt zonave të konfliktit. Në etapën e tretë, autoritetet mund t’u drejtohen drejtorive të shërbimeve sociale, mësuesve, etj. që të jenë të kujdesshëm për të rinj që shfaqin ndryshime të papritura sjelljeje, duke u vet-izoluar.

Gjatë fazës së katërt, masat që mund të ndërmerren mund të jenë të natyrë policore, përderisa ky mund të jetë edhe hapi i fundit përpara se ata t'i bashkohen grupeve terroriste në Siri dhe Irak. Ky model, si çdo model tjetër analitik në shkencat sociale e sidomos në studimet e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, ka kufizimet e tij, që lidhen me rastet kur individë të caktuar mund të radikalizohen jashtë këtij procesi, në mënyra të tjera, apo edhe individualisht, nëpërmjet internetit apo mjeteve të tjera. Megjithatë, ai rezulton shumë i dobishëm në rastin shqiptar të shpjegimit të procesit të ekstremizmit islamik.

### 3.7. Rëndësia e familjes në luftë: gratë dhe fëmijët në Siri dhe Irak

Një prej risive që has studimi mbi pjesëmarrjen e ekstremistëve shqiptarë në radhët e organizatave terroriste në Siri dhe Irak, është shpërngulja edhe e familjes së tyre në zonën e luftimeve. Sipas Peter Neumann nga ICSR, rreth 10-15 përqind e individëve që kanë udhëtuar në Siri janë femra.<sup>42</sup> Sa i takon Shqipërisë, sipas burimeve zyrtare, të paktën 13 shtetas shqiptarë janë zhvendosur në Siri gjatë periudhës 2012-'14 bashkë me gratë dhe rreth 31 fëmijë. Siç raporton rrjeti investigativ BIRN, një pjesë e fëmijëve kanë mbetur jetimë në Siri, pasi prindërit kanë humbur jetën në luftime. Referuar burimeve zyrtare, familjarët banojnë në shumicën e rasteve në kampe lufte, ndërsa baballarët luftojnë për grupet ekstremiste. Të paktën në një rast, një xhihadist që ishte në përgjim nga SHISH dhe Prokuroria, ka marrë në Siri fëmijët e tij pa pëlqimin e nënës së tyre, ndërsa dy punonjës policie e kanë ndihmuar atë t'i kalojë ata në mënyrë të paligjshme jashtë vendit.<sup>43</sup>

Transportimi i grave dhe fëmijëve në zonat e luftimit përbën risi për studimin e konflikteve. Së pari, ai mbështetet tek natyra patriarkale e familjes shqiptare, ku burrat mbajnë peshën kryesore, dhe tek lidhjet e forta midis pjesëtarëve të familjes. Së dyti, kjo tregon se shumë prej ekstremistëve nuk kishin më si qëllim rikthimin në vendin e tyre. Së

---

<sup>42</sup> Cituar në reportazhin e "The Economist" me titull: "It ain't half hot here, mum. Why and how westerners go to fight in Syria and Iraq". <http://www.economist.com/news/middle-east-and-africa/21614226-why-and-how-westerners-go-fight-syria-and-iraq-it-aint-half-hot-here-mum> (22/05/2015)

<sup>43</sup> Cituar tek Bogdani & Bezaj, referuar burimeve nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Bogdani, A. & Bezaj, F. (2014, 16 Dhjetor). *Dhjetëra fëmijë shqiptarë "pengje" të xhihadistëve në Siri*. (BIRN) Reporter.al. <http://www.reporter.al/dhjetra-femije-shqiptare-pengje-te-xhihadisteve-ne-siri/> (20/07/15).

treti, mund të vërehet një shkallë e lartë e ideologjizimit dhe indoktrinimit të tyre me idenë e “Tokës së Premtuar” apo Halifatit të madh islamik.

### 3.8. *E kaluara kriminale e ekstremistëve*

Luftëtarët e huaj të përfshirë në luftime në Siri dhe Irak jo rrallë kanë pasur të kaluar me rekorde kriminale. Kërkimi mbi qytetarët ka nxjerrë në pah faktin se disa prej ekstremistëve shqiptarë në Siri dhe Irak, kanë pasur të kaluar kriminale, si për krime të lehta ashtu dhe për krime më të rënda. Kërkimi mbi të kaluarën personale, për individët e njohur nga strukturat përkatëse, tregon se rreth një e treta e tyre (rreth 30 individë) janë përfshirë në vepra të mëparshme penale, të lehta ose të rënda. Madje për disa prej tyre ka referenca për përfshirje në më shumë se një rast veprimtarie kriminale. Krimet për të cilat janë hetuar, dënuar ose burgosur këta individë në të kaluarën përfshijnë: terrorizmin, zotërimin e jashtëligjshëm të armëve dhe municionit, vjedhje, grabitje të armatosura, tregti të jashtëligjshme armësh, trafikë droge dhe trafikë të qenieve njerëzore, përdhunim dhe dhunë në familje. Megjithatë ky nuk është tipar ekskluziv i ekstremistëve shqiptarë apo shqipfolës në Siri. Një studim i kohëve të fundit i një agjencie perëndimore inteligjence raporton se mbi gjysma (52%) e luftëtarëve të huaj që kanë mbërritur në Siri dhe Irak nga vendet e Bashkimit Evropian ishin kontingjent i njohur i krimit për policinë në komunitetet e tyre.<sup>44</sup>

Prania e individëve me të kaluar kriminale –si për krime të lehta ashtu dhe për krime të rënda– ndihmon të shpjegohet veprimet e dhunshme dhe brutaliteti i dëshmuar, sidomos duke përdorur propagandën mediatike, nga eksponentë terroristë të ISIL dhe Al-Nusra, duke përfshirë midis tyre edhe disa shqiptarë. Në këtë pikë përmendim përfshirjen e një grupi ekstremistësh shqiptarë, me në krye Lavdrim Muhaxherin, në shfaqje ekstreme dhe brutale si prerje kokash apo ekzekutime të ndryshme. Kjo provon edhe se një prej objektivave të fushatës së rekrutimeve të ISIL është shënjestrimi i një grupi specifik individësh që kanë të kaluar kriminale, siç provon dhe slogani i vetë organizatës: “Ndonjëherë njerëzit me të kaluarën më të keqe mund të krijojnë të ardhmen më të mirë”.

---

<sup>44</sup> Cituar tek Archick, K. & Belkin, P. (2015, Prill). *European Fighters in Syria and Iraq: Assessments, Responses, and Issues for the United States*. US: Congressional Research Service, 7-5700, R44003, f. 28. Raport i paraqitur për llogari të Kongresit të SHBA.



Ky përbën një fenomen të hasur gjerësisht brenda komuniteteve fetare, ku ai mysliman nuk përbën përjashtim.<sup>45</sup> Procesi i radikalizimit të individëve të caktuar brenda në qendrat e kryerjes së dënimit është masivizuar vitet e fundit dhe është zgjeruar gjeografikisht, për shkak se për shumë individë shihet si një formë e pastrimit shpirtëror.

### 3.9. *Kthimi në shtëpi: ri-integrimi dhe de-radikalizimi*

Një aspekt i rëndësishëm i këtij studimi lidhet me rreth individët e kthyer. Siç u përmend më lart, numri i tyre është relativisht i lartë, rreth 40, krahasuar me numrin e përgjithshëm të xhihadistëve shqiptarë, të përfshirë në konflikt.

Së pari, ka shumë rëndësi të vihet në dukje impakti psikologjik i luftës. Studimet mbi profilin psikologjik të ekstremistëve të përfshirë në luftime në konfliktet e mëparshme tregojnë se shumica e tyre vuajnë, ose janë shumë të predispozuar të vuajnë fill pas kthimit në atdhe, nga çrregullime psikike dhe simptoma të stresit post-traumatik.<sup>46</sup> Për shkak të numrit të lartë të shqiptarëve të kthyer nga luftimet në Siri dhe Irak, ky dimension psikologjik duhet marrë seriozisht parasysh, jo vetëm për trajtimin e tyre klinik, por edhe për riintegrimin e mundshëm në shoqëri.

Një prej dimensioneve më problematike të përballjes me ekstremizmin e dhunshëm lidhet me sfidat e de-radikalizimit të tyre pas kthimit në atdhe. Siç rezulton nga intervistat me aktorët fetarë por edhe me zyrtarë kyçë, de-radikalizimi është një proces shumë i vështirë dhe suksesi i tij nuk është i garantuar.<sup>47</sup> Vështirësia kryesore qëndron tek eksperiencat e thella psikologjike nga luftimet që kanë përjetuar shumë prej xhihadistëve. Ndonëse disa shfaqen të penduar dhe të zhgënjyer prej asaj që përjetuan, shumë të tjerë e kanë të vështirë të heqin dorë nga bindjet ekstremiste dhe doktrina e tyre fetare (tekfiriste) për të cilat kanë sakrifikuar aq shumë në Siri dhe Irak.

Riintegrimi dhe de-radikalizimi janë dy procese të thella që kanë dimensione sociale, politike dhe sigurie. Dimensionin social prek procesin e de-radikalizimit nga pikëpamja e riintegritimit në shoqëri. Në prizmin politik, këto dy procese duhen parë si

---

<sup>45</sup> Archick, K. & Belkin, P. (2015, Prill). *European Fighters in Syria and Iraq: Assessments, Responses, and Issues for the United States*. US: Congressional Research Service, 7-5700, R44003, f. 2.

<sup>46</sup> Byman, D. & Shapiro J. (2014). *Homeward Bound? Don't Hype the Threat of Returning Jihadists*. Foreign Affairs, Nëntor/Dhjetor.

<sup>47</sup> Intervistë me Arben Ramkaj, Myftiu i Elbasanit, ibid.

përgjegjësi e shtetit për t'u përballur me xhihadistët e rikthyer jo vetëm me mjete represioni apo policore (ligjzbatuese), por edhe me ndryshimin apo plotësimin e kuadrit ligjor për t'iu përshtatur kësaj situatë të re. Për këtë arsye, qeveria shqiptare ka kërkuar dhe ka siguruar nga parlamenti ndryshimin e kodit penal (Neni 265/a,b,c) mbi pjesëmarrjen e shtetasve shqiptarë në konflikte të armatosura në vende të tjera (seksioni pasardhës ndërmerr një analizë më të detajuar të kuadrit ligjor dhe strategjive të shtetit shqiptar). Parë në këndvështrimin e sigurisë kombëtare, këto procese kanë nevojë për një strategji dhe/ose plan veprimi kombëtar për të garantuar de-sigurizimin (ose zhvendosjen nga axhenda politike) e fenomenit të ekstremizmit islamik.

Siç u përmend më lart, numri i ekstremistëve të kthyer në Shqipëri nga luftimet në Siri dhe Irak është rreth 40. Një prej kufizimeve që ka hasur ky studim lidhet me vështirësitë për të intervistuar disa prej të kthyerve, për të kuptuar sesi ka ndodhur i gjithë cikli i radikalizimit, itinerarit të udhëtimit drejt zonave të konfliktit, pjesëmarrjes në luftime, kthimit në atdhe, etj. Megjithatë analiza në vijim bazohet në raportimet për një pjesë të të kthyerve në vende të tjera perëndimore dhe të rajonit, përfshirë edhe Kosovën.

Këta individë i kanë vendosur autoritetet shqiptare përballë një sfide të sigurisë kombëtare për shkak të aftësive të fituara gjatë konfliktit, për shkak të lidhjeve të tyre potenciale me ekstremistët në rajon apo Evropë si dhe për shkak të lidhjeve që mund të mbajnë me ekstremistët në zonat e konfliktit. Ndonëse ka ndryshuar legjislacioni shqiptar dhe kodi penal për të kriminalizuar pjesëmarrjen në veprime luftarake në një shtet të huaj, një pjesë e tyre nuk preken nga ky ligj, sepse janë kthyer përpara se ligji të hynte në fuqi. Ndërsa ka diskutime sa i takon një pjese tjetër të ekstremistëve, që ndodhen aktualisht në zonat e luftimeve dhe dëshirojnë të kthehen, pasi ekzistenca e këtij ligji dhe mundësia e arrestimit të tyre, e bën të vështirë, deri të pamundur, një kthim të mundshëm vullnetar.

Nga shqyrtimi i gjetjeve rezulton se shumë të kthyerve përdorin mediat sociale ku ofrojnë informacione të detajuara mbi zhvillimet aktuale në konflikt, dokumentojnë eksperiencat e tyre, bëjnë thirrje hera-herës për t'iu bashkuar luftimeve si dhe ofrojnë informacion të dobishëm sesi mund të shkohet në Siri. Pjesëmarrja në grupet ekstremiste i bën të shihen si heronj dhe si burim frymëzimi për një brez të rinjsh me prirje radikale.

Nga ana tjetër, xhihadistët e kthyer tashmë mund të konsiderohen veteranë të trajnuar dhe me eksperiencë në përdorimin e armëve dhe të eksplozivëve, duke rritur

gjasat e aktivitetit terrorist brenda vendit, apo edhe në rajon. Jo vetëm kaq, por shumë prej ekstremistëve kthehen të sprovuar në teknikat e luftimit gueril urban dhe me një rrjet të gjerë kontaktesh për të ndërtuar një rrjet xhihadist global.<sup>48</sup> Kjo sfidë e drejtpërdrejtë ndaj sigurisë kombëtare përforcohet nga fakti se gjatë muajve të fundit ka pasur rreth 20 sulme terroriste në vende si Franca, Belgjika, Australia, Kanadaja, Tunizia –duke mos e përjashtuar as Shqipërinë për shkak të pjesëmarrjes aktive në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar– përveç një numri tjetër sulmesh në Irak, që lidhen të gjitha me konfliktin në Siri dhe Irak dhe nxitjen ose përfshirjen e drejtpërdrejtë të ISIL.<sup>49</sup>

Problemi bëhet edhe më i mprehtë sepse nuk duhet nënvlerësuar bindja e tyre e thellë tek ekstremizmi i dhunshëm për të përçuar dhe/ose mbrojtur ato që sipas tyre janë bindjet e tyre fetare. Siç ka rezultuar në disa raste kthimi në vendet evropiane, disa prej ekstremistëve mund të kthehen me detyra të qarta për të ngritur grupe të caktuara ekstremiste brenda vendit ose për të krijuar celula terroriste që do të dërgojnë njerëz në front, duke shërbyer si nyje lidhëse për shkak të kontakteve që mund të kenë atje.

Por ata mund të shërbejnë edhe si nyje lidhëse për rrjetet rajonale, si lidhje me ekstremistët në Kosovë, Maqedoni apo edhe në vendet e BE-së për shkak të lidhjeve që mund të kenë krijuar atje me xhihadistë nga Kosova apo Evropa. Sipas Charles Farr, drejtorit të Zyrës Kundër Terrorizmit të Mbretërisë së Bashkuar, “Siria i ka ndryshuar thellësisht rregullat e lojës”. Ai argumenton se “këta njerëz jo vetëm që kthehen me ide radikale, por janë të traumatizuar dhe shpesh plotësisht të gatshëm të përdorin dhunë”.<sup>50</sup>

Një funksion tjetër i këtyre individëve mund të jetë përdorimi si nyje lokale (ballkanike) të mbështetjes logjistike, për të grumbulluar fonde apo financime për të dërguar ekstremistë të tjerë në front. Nga ana tjetër, të dhënat e sondazhit të AIIIS tregojnë një shkallë të lartë tolerance dhe pranueshmërie të opinionit publik shqiptar për ekstremistët e kthyer nga luftimet në Siri dhe Irak, duke përkrahur përpjekjet për

---


<sup>48</sup> Byman, D. & Shapiro, J. (2014, Nëntor). *Be Afraid. Be a Little Afraid. The Threat of Terrorism from Western Foreign Fighters in Syria and Iraq*. Policy Paper No. 34, Foreign Policy Series, Brookings Institution, f. 2.

<sup>49</sup> Siç pranon dhe vetë Andrew Parker, Drejtori i MI5 (një prej shërbimeve britanike të inteligjencës), midis fundit të vitit 2014 dhe fillimit të vitit 2015 janë parandaluar 3 sulme të planifikuara terroriste që lidhen me zhvillimet në Siri dhe Irak. Nelson, F. (2015, Janar). *Six key points from MI5's Andrew Parker speech on the terror threat in Britain*. UK: The Spectator.

<sup>50</sup> Lynch, C. (2013, Korrik). *Europe's New 'Time Bomb' is Ticking in Syria*. Foreign Policy. [http://www.foreignpolicy.com/articles/2013/07/09/european\\_fighters\\_jihadists\\_syria?page=0,1](http://www.foreignpolicy.com/articles/2013/07/09/european_fighters_jihadists_syria?page=0,1) (14/04/2015)

riintegrimin e tyre në shoqëri. Kështu, 51.9% e të intervistuarve shprehen në favor të riintegrimin, përkundrajt 24.3% që shprehen në favor të ndëshkimit ligjor dhe burgosjes së tyre (*Grafiku 6*).

*Grafiku 6: Reagimi i qeverisë për individët e kthyer nga konflikti në Siri dhe Irak*



Megjithatë është e rëndësishme të kuptohet se shumë prej tyre mund të kthehen krejtësisht të zhgënjyer nga përjetimet e tyre në konflikt. Ata mund të përdoren si shembull për komunitetin e tyre ose më të gjerë, për të delegjitimuar si të papranueshëm ekstremizmin dhe radikalizmin islamik. Aspekti vendimtar i programeve të de-radikalizimit dhe riintegrimin të ekstremistëve në shoqëri duhet të jetë sigurimi nga institucionet shtetërore i asistencës praktike për t'u shkëputur nga mjedisi i mëparshëm shoqëror dhe fetar për një periudhë të caktuar kohore, punësimi, arsimimi, etj (shih 4.2. *Rekomandime*).

### 3.10. Reagimi i shtetit: ndryshimet e kuadrit ligjor, ri-strukturimi institucional, strategjia e qeverisë për t'u përballur me fenomenin

Përtej proceseve të de-radikalizimit dhe riintegrimin gjatë dy viteve të fundit shteti shqiptar ka zhvilluar një tërësi instrumentesh dhe mekanizmash, të brendshëm dhe të jashtëm, për t'u përballur me radikalizmin islamik dhe ekstremizmin e dhunshëm.

### 3.10.1. *Kuadri ndërkombëtar*

Përfshirja e ekstremistëve nga shumë vende në luftën në Siri dhe Irak, si dhe frika e angazhimit të tyre në rekrutimin, përgatitjen ose përdorimin e dhunës pas pjesëmarrjes atje, ka nxitur Kombet e Bashkuara t'u kërkojnë shteteve-anëtare ndryshimin e sistemeve të tyre juridike për të ndëshkuar këta individë. Ky detyrim specifikohet në Rezolutën 2178 të Këshillit të Sigurisë<sup>51</sup> mbi shkëmbimin e të dhënave mbi personat e dyshuar për pjesëmarrje në aktivitete terroriste.

Sa u takon mekanizmave dhe instrumenteve të jashtëm, së pari, si shtet-anëtar i NATO-s, Shqipëria është përfshirë prej më shumë se një dekade në koalicionet ndërkombëtare kundër terrorizmit.<sup>52</sup> Ajo ka qenë gjithashtu shumë aktive diplomatikisht në forume dhe organizata ndërkombëtare, duke u bërë palë e konventave, traktateve apo iniciativave anti-terrorizëm në kuadrin e OKB-së<sup>53</sup>, OSBE-së, Këshillit të Evropës<sup>54</sup>, si dhe përkundrejt detyrimeve ndaj Bashkimit Evropian<sup>55</sup>, si vend kandidat për t'u anëtarësuar në organizatë. Përveç këtyre angazhimeve, Shqipëria ka bashkëpunuar mbi çështje që lidhen me terrorizmin edhe në kuadrin e partneriteteve rajonale, si SECI, BSEC, AII, CEI apo SEECF.<sup>56</sup> Në vitin 2011 Shqipëria ka nënshkruar Deklaratën për Bashkëpunimin Policor në Luftën kundër Terrorizmit Ndërkombëtar, duke iu bashkuar iniciativës, me Bosnjë-Hercegovinën, Slloveninë, Serbinë, Malin e Zi, Austrinë. Përveç angazhimeve shumëpalëshe, Shqipëria ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh dypalëshe bashkëpunimi për luftën kundër terrorizmit, me Bosnjë-Hercegovinën (2010), Letoninë (2010), Maqedoninë (2005), Serbinë (2010), Turqinë (2008) dhe Rumaninë (2002).

### 3.10.2. *Kuadri legjislativ*

---

<sup>51</sup> [\(http://www.un.org/en/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=S/RES/2178%20\(2014\)\)](http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/RES/2178%20(2014)) (12/07/2015).

<sup>52</sup> [\(http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2013/224822.htm\)](http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2013/224822.htm) (12/07/2015).

<sup>53</sup> Një listë e plotë e traktateve që ka nënshkruar Shqipëria në OKB në lidhje me luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar gjendet tek: [https://treaties.un.org/Pages/DB.aspx?path=DB/studies/page2\\_en.xml](https://treaties.un.org/Pages/DB.aspx?path=DB/studies/page2_en.xml) (12/07/2015).

<sup>54</sup> Në vitin 2007 Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit. Ajo është gjithashtu pjesë e Komisionit të Ekspertëve të Vlerësimit të Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të Këshillit të Evropës.

<sup>55</sup> Shqipëria është anëtare e Konventës Evropiane për Shtypjen e Terrorizmit.

<sup>56</sup> CODEXTER (2014, Nëntor). *Profiles of Counter-Terrorist Capacity: Albania*. Council of Europe, f. 1.

Përveç këtij kuadri të dënuar aktesh juridike dhe normative ndërkombëtare, Shqipëria ka zhvilluar edhe një kuadër të brendshëm po aq të ngjeshur ligjor, institucional dhe strategjik për t'u përballur me veprimtaritë terroriste, burimet e financimit të terrorizmit dhe, së fundmi, me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe qytetarëve shqiptarë të angazhuar në vatra konfliktesh jashtë territorit të vendit.

Dispozitat ligjore të luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm janë pjesë e të drejtës penale. Sipas Nenit 28/2: “organizata terroriste është një lloj i veçantë organizate kriminale, e përbërë nga ose më shumë persona, që kanë bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me qëllim kryerjen e akteve terroriste”. Kreu VII i Kodit Penal përmban edhe 17 nene të tjerë ku përfshihen të gjitha llojet e dhunës terroriste: si krijimin e organizatave terroriste; financimin e terrorizmit; grumbullimin e fondeve për financimin e terrorizmit; rekrutimin e një ose më shumë personave për kryerjen e akteve terroriste; trajnimin me qëllim kryerjen e akteve terroriste; promovimin, thirrjet publike dhe propagandën për kryerjen e aktiviteteve dhe kërcënimeve me qëllim kryerjen e akteve terroriste; e kështu me radhë.<sup>57</sup> Është amenduar gjithashtu Neni 230 i Kodit Penal, për të përfshirë krime me natyrë terroriste me qëllim përhapjen e panikut në popullsi, shkatërrimin ose destabilizimin e strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose shoqërore të shtetit shqiptar, të tilla si: i) rrëmbimi i personave; ii) dëmtimi serioz i pronës publike, infrastrukturës, sistemit të transporteve, sistemeve informatike, rrëmbimi i avionëve, anijeve ose mjeteve të tjera të transportit; iii) prodhimi, blerja ose zotërimi i lëndëve shpërthyese, armëve biologjike, kimike, bërthamore, apo kërkimet për këto armë të shkatërrimit në masë; etj.<sup>58</sup>

Neni 230/a merret me financimin e terrorizmit, duke e dënuar atë me jo më pak se 15 vite burg, ndërsa 230/b trajton fshehjen e fondeve që përdoren për të financuar akte terroriste. Në vitin 2007 janë bërë disa ndryshime të tjera të Kodit Penal (në Nenin 231) për të reflektuar detyrimet e vendit me ratifikimin e Konventës të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, duke dënuar edhe: “rekrutimin e individëve me qëllim kryerjen e akteve terroriste ose financimin e akteve terroriste, edhe kur këto akte

---

<sup>57</sup> [http://www.pp.gov.al/web/kodi\\_penal\\_2013\\_shtatordoc\\_823.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2013_shtatordoc_823.pdf) (12/07/2015).

<sup>58</sup> Ibid.

drejtohen kundër një shteti, institucioni ose organizate tjetër ndërkombëtare [...]”.<sup>59</sup> Edhe nenet pasuese të Kodit Penal shqiptar trajtojnë gjerësisht problematikat e ndryshme juridike të terrorizmit, si Nenet 6, 7, 232 (a/b), 233 dhe 234.

Ndërkohë, legjislacioni penal (Kodi i Procedurave Penale) nuk parashikon procedura të posaçme hetimore për rastet e terrorizmit, ndonëse ka dispozita të posaçme për konfiskimin e pasurive,<sup>60</sup> për shkak të angazhimeve ndërkombëtare që ka marrë Shqipëria në përputhje me Rezolutat 1267 dhe 1373 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së. Në 10/10/2013 Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin nr. 157 për “Masat kundër financimit të terrorizmit”. Kohët e fundit qeveria ka kërkuar edhe ndryshimin e Nenet 265/a,b,c të Kodit Penal. Këto nene parashikojnë dënimin e individëve për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj (Neni 265/a); organizimin për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj (Neni 265/b); dhe thirrjen për pjesëmarrje në veprime luftarake e të dhunshme në një shtet të huaj (Neni 265/c). Këto klauzola të Kodit Penal plotësojnë kështu një kuadër shumë të gjerë dhe të thellë juridik mbi veprimtaritë terroriste, ekstremizmin e dhunshëm dhe financimin e veprimtarive terroriste në Shqipëri.

### 3.10.3. *Kuadri strategjik*

Shqipëria ka zhvilluar një kuadër strategjik të përballjes me terrorizmin ndërkombëtar, i cili u intensifikua sidomos pas vitit 2001. Për herë të parë terrorizmi përmendej në mënyrë sistematike si kërcënim ndaj sigurisë kombëtare në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të vitit 2004. Kjo strategji është rishikuar në themel, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (SSK), e miratuar në parlament në vitin 2014, duke e kontekstualizuar terrorizmin si kërcënim të brendshëm, jo vetëm ndërkombëtar.<sup>61</sup> SSK integron për herë të parë në një dokument strategjik ekstremizmin ideologjik, fetar dhe nacionalist që ushqen aktivitetet terroriste. Sipas SSK (2014): “Ideologjitë ekstreme bazohen tek padija, varfëria, mungesa e shërbimeve shtetërore dhe lidhjet e shumëfishta

<sup>59</sup> [http://www.pp.gov.al/web/kodi\\_penal\\_2013\\_shtatordoc\\_823.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2013_shtatordoc_823.pdf) (12/07/2015).

<sup>60</sup> Ligji 10192, datë 14/11/2009, për “Parandalimin e krimit të organizuar dhe trafiqeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pronës”.

<sup>61</sup> Sipas SSK (2014): “terrorizmi ndërkombëtar dominon spektrin e kërcënimeve asimetrike dhe përbën kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë rajonale dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Shqipëria është ekspozuar ndaj rrezikut potencial të një sulmi terrorist si vend anëtar i NATO-s dhe për shkak të kontributit të saj për paqen dhe sigurinë globale”. [http://www.parlament.al/web/pub/teksti\\_17880\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/teksti_17880_1.pdf) (15/07/2015).

në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto shkaqe krijojnë terrenin e favorshëm për rekrutimin e individëve vulnerabël për të marrë pjesë në konflikte ndërkombëtare. Për shkak të tendencës së tij ekspansioniste, ekstremizmi mund të përbëjë kërcënim për kohezionin dhe vlerat e shoqërisë Shqiptare.”<sup>62</sup> Kuadri strategjik plotësohet me dy dokumente të tjerë: i) Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit (2011-2015) dhe planin e saj të veprimit (2011-2015)<sup>63</sup>; dhe ii) Strategjinë Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit (2013-2020) dhe planin e saj të veprimit (2013-2016).<sup>64</sup>

Në aspektin institucional është krijuar një strukturë e re brenda policisë shqiptare, Drejtoria e Anti-Terrorit, me mision zvogëlimin e rrezikut ndaj terrorizmit në Shqipëri dhe funksion koordinimin e të gjitha veprimtarive ligjzbatuese me institucionet e tjera si Shërbimi Informativ Kombëtar, Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes dhe Njësia e Inteligjencës Financiare, në përballje me terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin fetar.

### *3.11. Reagimi i shoqërisë dhe i KMSH-së*

Kjo tablo institucionale, legjislative dhe strategjike nuk duhet të anashkalojë rolin e shoqërisë civile, komunitetit fetar mysliman dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë, të cilët mund të shërbejnë si ura bashkëpunimi dhe koordinimi të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë kuptim, bashkëpunimi i institucioneve shtetërore me KMSH dhe shoqërinë civile merr rëndësi parësore për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin islamik, duke i kushtuar vëmendje të veçantë marrëdhënieve me komunitetin e besimtarëve në rajone kyçe.

Megjithatë, siç u përmend më lart, mungesa e ndihmës financiare shtetërore për komunitetet fetare ka qenë një ndër faktorët kryesorë që ka lehtësuar penetrimin e influencave të huaja ekstremiste fetare në Shqipërinë postkomuniste. Kjo është e vërtetë edhe për institucionin e Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH). Siç shprehen edhe disa prej drejtuesve dhe ish-drejtuesve të komunitetit, të intervistuar për qëllimet e këtij

---

<sup>62</sup> SSK (2014), *ibid.*, f. 23.

<sup>63</sup> Miratuar me VKM Nr. 675 (06/07/2011).

<sup>64</sup> Miratuar me VKM Nr. 663 (17/07/2013).



studimi, vështirësitë financiare të KMSH-së kanë qenë shqetësimi kryesor gjatë viteve të para.<sup>65</sup> Duke pasur parasysh kushtet ekonomike në fillim të viteve 1990-të, bashkësia vendase e besimtarëve nuk gëzonte burimet e nevojshme për të rindërtuar xhamitë, shkollat fetare, nuk kishte sa duhet njerëz të kualifikuar për të ngarkuar me detyrat e klerit dhe as burimet financiare për të paguar këtë personel. Kjo lehtësoi penetrimin e një numri të konsiderueshëm fondacionesh nga vendet arabe, të cilat siguronin mjete të mjaftueshme financiare për funksionimin e komunitetit mysliman.

Në Shqipëri vepronin rreth 20 fondacione të huaja arabe dhe islamike, prania dhe veprimtaria e të cilave ishte shumë intensive. Si pasojë e mungesës shumëvjeçare të burimeve financiare, KMSH u bë gjithnjë e më i varur nga fondet e fondacioneve të huaja. Intensiteti i veprimtarisë së këtyre aktorëve ishte i madh sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të parë, kur kontrolli i shtetit ishte në nivele minimale. Siç rezultoi gjatë viteve në vijim, këta aktorë përbënin një burim kryesor të shqetësimeve për sigurinë dhe terrorizmin ndërkombëtar, me lidhje të forta me organizatat terroriste të Lindjes së Mesme dhe jo vetëm. Nga ana tjetër, fondacionet, përveç aktiviteteve me karakter fetar, janë përfshirë edhe në veprimtari të shumta bamirëse, si ndihmë për jetimoret, qendrat sanitare, etj. Fondacionet nga Lindja e Mesme kanë tërhequr vëmendjen për disa zhvillime negative. Prania e tyre në Shqipëri dhe aktiviteti brenda komunitetit mysliman, me shtrirjen e tyre kapilare, përbënte kërcënim në tri mënyra kryesore: i) në praktikat fetare të panjohura më parë; ii) në idetë e rrezikshme që këto fondacione sollën në vend; si dhe iii) fshehjen brenda tyre të elementëve ekstremistë dhe terroristë.<sup>66</sup>

Në veçanti përhapja e Salafizmit dhe Wahhabizm-it paraqitet si ilustrim i natyrës fundamentaliste të këtyre organizatave, duke krijuar premisat për radikalizimin e islamit shqiptar dhe ekstremizmin e dhunshëm.<sup>67</sup> Bashkëpunimi i tyre me KMSH-në ka qenë i dobët, pasi fondacionet kanë përhapur traditat e tyre fetare, duke hapur kurse dhe shkolla fetare që nuk funksiononin sipas rregullave të komunitetit. Mendohet se aktualisht janë

---

<sup>65</sup> Intervistë me Z. Ermir Gjinishi, ish-Zv/Kryetar i Komunitetit Mysliman (10/07/2015) E njëjta problematikë rezulton edhe nga opinionet e aktorëve të tjerë të informuar, si Myftiu i Elbasanit, Arben Ramkaj (12 mars 2015).

<sup>66</sup> Bumçi, A. (2004). *Çështje të Sigurisë Kombëtare. Rasti i Shqipërisë. Kufiri, Feja Korrupsioni*. Tiranë: AIIS Press: f. 60.

<sup>67</sup> Tradita saudite e islamit shihet si variant konservator, radikal e puritanist, që nuk përputhet me traditën tone tolerante. Bumçi, A. (2004). *Çështje të Sigurisë Kombëtare. Rasti i Shqipërisë. Kufiri, Feja Korrupsioni*. Tiranë: AIIS Press: f. 60.

disa xhami të cilat nuk janë vendosur nën kontrollin e KMSH-së, kjo edhe për shkak se ndërtimi i tyre nuk është financuar nga Komuniteti, por nga fondacione islamike, ose nga vetë besimtarët.<sup>68</sup> Dobësia e strukturave të KMSH-së por edhe atyre shtetërore (si Shërbimi Informativ apo institucione të tjera) për të mbikëqyrur veprimtarinë e këtyre fondacioneve, krijoi premiset e radikalizimit fetar të grupeve të vogla të individëve, të cilat ishin më të prirur të përqafonin idetë ekstremiste.

Në kuadër të politikës së përhapjes së traditës së tyre fetare, këto fondacione kanë qenë mjaft aktive edhe në përgatitjen e brezit të ardhshëm të klerikëve, duke financuar studimin e tyre në universitete fetare të vendeve arabe. Kthimi i kësaj gjenerate studentësh shqiptarë të shkolluar në vendet arabe, ndryshoi natyrën e ndikimit të fondacioneve arabe. Studentët shqiptarë që dërgoheshin me studime jashtë nga fondacione të ndryshme islamike, përbënin shqetësim, pasi vendet dhe universitetet ku kanë studiuar ata konsiderohen burime të radikalizimit dhe ekstremizmit islamik. Këta individë mund t'i jenë nënshtruar një procesi radikalizimi ose deformimi të islamit tradicional shqiptar, me pasoja afatgjata për krijimin e celulave ekstremiste brenda komuniteteve lokale myslimane shqiptare. Një prej rasteve më tipike është ai i Genci (Abdurrahim) Ballës, një imam 35-vjeçar i arsimuar në Arabinë Saudite, i cili është arrestuar në prill 2014 gjatë një operacioni anti-terror të autoriteteve shqiptare, me dyshimin se drejtonte një rrjet rekrutimesh dhe se kishte çuar në Siri dhjetëra luftëtarë të jashtëligjshëm. Bashkë me të është arrestuar edhe Bujar Hysa, një tjetër imam, si dhe një numër bashkëpunëtorësh të tjerë.<sup>69</sup> Këta imamë kishin lidhje të ngushta me grupet ekstremiste në Kosovë si dhe me një rrjet prej 14 shoqatash bamirëse dhe kulturore islamike, liderët e të cilave ishin arsimuar gjithashtu në Lindjen e Mesme, dhe autoritetet e Kosovës i kishin mbyllur kohët e fundit për shkak të lidhjeve të tyre me organizatat ekstremiste islamike si Vëllazëria Myslimane.<sup>70</sup>

Megjithatë, Shqipëria kishte nevojë të madhe për personel të kualifikuar që të punonte në institucione të ndryshme të Komunitetit Mysliman, të jepte mësim në Medrese, etj. Për të përmbushur këto nevoja, shumë shqiptarë u dërguan për të studiuar

---

<sup>68</sup> Miranda Vickers, "Islam in Albania," Defense Academy of the United Kingdom, March 1, 2008.

<sup>69</sup> (<http://www.oranews.tv/vendi/rekrutinin-shqiptare-per-ne-siri-7-te-arrestuar-mes-tyre-dhe-dy-imame-ja-emrat/> - 05/07/2015).

<sup>70</sup> Bytyci, F. (2014). *Indebted to America, Kosovo Struggles to Curb Islamist Recruits*. Reuters.

në vendet arabe dhe në Turqi. Në mungesë të institucioneve shqiptare të arsimit të lartë në fushën teologjike, të paktën deri në fund të viteve 2000, kur filloi të funksionojë edhe një institucion arsimor privat teologjik, kjo ishte mundësia e vetme e shkollimit. Nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi numrin e shqiptarëve që kanë studiuar në Lindjen e Mesme dhe Turqi ndër vite dhe mbi numrin e atyre që i kanë financuar studimet prej fondacioneve apo vetë KMSH-së. Gjithsesi besohet se ky numër nuk i kalon disa qindra individë, shumica dërrmuese e të cilëve janë kthyer në Shqipëri. Një pjesë e tyre kanë vijuar karrierën teologjike, ndërsa të tjerë kanë zgjedhur t'i drejtohen shkollimit të mëtejshëm. Ajo çka bie në sy është pozicionimi i shumë prej atyre që kanë vijuar karrierën fetare në pozicione kyçe.

Kthimi i këtyre individëve, përveç problemit të përfaqimit të radikalizmit fetar, krijoi edhe një problem të ri brenda komunitetit mysliman. Gjenerata e re e teologëve ishte kritike ndaj personave në krye, të cilët konsideroheshin “një brez i vjetër” dhe i pakualifikuar teologjikisht për të qëndruar në poste drejtuese. Teologët e rinj kërkonin përfaqësim më të madh në strukturat drejtuese. Edhe pse kjo përplasje për pushtet brenda KMSH-së ka qenë më e theksuar dhe publike rreth viteve 1998-'99, aktualisht nga kërkimet dhe intervistat tona me aktorë kyç të komunitetit dhe jashtë tij, konstatohet se karakteri i luftës për pushtet është i brendshëm dhe i izoluar.<sup>71</sup>


Nga ana tjetër shumë prej konflikteve në degët e ndryshme të KMSH-së kanë pasur lidhje me pronat, me akuza për keqadministrimin e tyre. Problemi i pronave lidhet ngushtë me mundësinë e komunitetit për të fituar pavarësi dhe qëndrueshmëri më të madhe financiare. Për shkak të kthimit të pamjaftueshëm të pronave nga shteti ndër vite, KMSH është detyruar të mbështetet historikisht tek ndihma e huaj. Kthimi i pronave të komunitetit dhe administrimi i duhur i tyre do ta rriste ndjeshëm pavarësinë e tij financiare. Por, më gjerësisht, problemi i pronave në Shqipëri është një ndër problemet më kyçe të tranzicionit. Ndonëse kanë kaluar mbi dy dekada e gjysëm nga shembja e komunizmit, ai vijon të mbetet një çështje e mprehtë kombëtare. Kjo nxjerr në pah implikimet për sigurinë kombëtare dhe stabilitetin e institucioneve fetare që prodhon paaftësia e elitës politike dhe e institucioneve shtetërore gjatë tranzicionit për të zgjidhur çështje madhore kombëtare.

---


<sup>71</sup> Intervista me Arben Ramkaj, Myftiu i Elbasanit (12/03/2015).

Nga ana tjetër, siç rezulton nga të dhënat e sondazhit të AIIS-së për qëllimet e këtij studimi, kur të intervistuarit pyeten në lidhje me pranueshmërisë e veprimtarisë radikale, shumica dërrmuese e shqiptarëve (83.7%), nuk janë dakord me ideologjinë dhe aktivitetin terrorist të ISIL dhe organizatave të tjera (*Grafiku 7*). Për më tepër, shumica dërrmuese e të intervistuarve (83.3%) shprehen kundër pjesëmarrjes së qytetarëve shqiptarë në radhët e organizatave terroriste (*Grafiku 8*).

*Grafiku 7: Pranueshmëria e ideologjisë fetare dhe sjelljes së ISIL – AIIS 2015*




*Grafiku 8: Reagimi i opinionit publik mbi pjesëmarrjen e shqiptarëve në konfliktin në Siri dhe Irak- AIIS 2015*



Qasja shumëdimensionale kundër fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe pjesëmarrjes së qytetarëve shqiptarë në konflikte jashtë vendit, përkon sakaq me gjetjet e


sondazhit. Të intervistuarit bien dakord (34.9%) se ka nevojë për një angazhim gjithëpërfshirës të institucioneve shtetërore të sigurisë, për nevojën e programeve të deradikalizimit fetar, për angazhimin më të madh të shërbimeve të inteligjencës për të ndaluar rekrutimet e të rinjve si dhe për nevojën e punësimit të të rinjve, sidomos në zonat rurale apo periferitë e qyteteve të mëdha, ku ekspozimi ideologjik është më i madh. (Grafiku 9).

Grafiku 9: Veprimet e qeverisë për të parandaluar rekrutimin e shqiptarëve në Siri dhe Irak – AHS 2015




Edhe angazhimet e vendit kundër terrorizmit dhe ekstremizmit shqiptar shfaqin një nivel të lartë pranueshmërie edhe nga opinioni publik, bazuar në rezultatet e sondazhit të AHS-së (ku rreth 73.9% e të intervistuarve mbështet përfshirjen në koalicione kundër ekstremizmit fetar – Grafiku 10).

Grafiku 10: Pranueshmëria e përfshirjes së Shqipërisë në luftë kundër ekstremizmit fetar



Megjithatë, të pyetur në lidhje me informacionin mbi punën e KMSH-së, të intervistuarit përgjigjen në shumicë se nuk i ndjekin (nuk kanë kontakt) veprimtaritë e komunitetit. Në këtë mënyrë, sondazhi zbulon krijimin e një hendeku komunikimi midis KMSH-së dhe opinionit publik shqiptar (*Grafiku 11*). Kjo nxjerr në pah nevojën e një strategjie të mirëfilltë komunikimi të KMSH jo vetëm me besimtarët myslimanë, por me gjithë shoqërinë, për të eliminuar në planin afatgjatë stereotipet dhe paragjykimet e mundshme.

*Grafiku 11: Informimi i publikut mbi aktivitetet dhe punën e KMSH-së*



### 3.12. Implikime në integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Përveç marrëveshjeve dypalëshe për luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm me shtetet e rajonit dhe vendet-anëtare të Bashkimit Evropian, Shqipëria ka intensifikuar vitet e fundit bashkëpunimin institucional me BE-në në kuadrin e procesit të saj të integritit. Kështu, Kapitulli 3 i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (2006) midis BE-së dhe Shqipërisë, i referohet në mënyrë specifike (Nenet 82 dhe 84) bashkëpunimit kundër terrorizmit. Neni 82 parashikon bashkëpunimin midis palëve për të parandaluar financimin e terrorizmit, ndërsa sipas Nenit 84 palët bien dakord të bashkëpunojnë për të parandaluar akte terrorizmi, në veçanti ato me natyrë ndërkufitare. Bashkëpunimi përfshin shkëmbimin e informacionit mbi grupet terroriste dhe rrjetet e tyre mbështetëse në përputhje me ligjet ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe shkëmbimin e eksperiencave mbi mjetet, metodat dhe trajnimin në luftën kundër terrorizmit.<sup>72</sup>

Nga ana tjetër, duke qenë prej qershorit 2014 vend-kandidat për t'u anëtarësuar në BE, Shqipërisë i duhet të plotësojë një sërë kriteresh, me karakter juridik, politik, ekonomik e social, mes të cilave luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikëve të jashtëligjshme. Sipas Progres-Raportit të Komisionit Evropian të vitit 2014, në fushën e luftës kundër terrorizmit Shqipëria ka vijuar të implementojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit, duke futur disa amendamente në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale si dhe duke ndërmarrë hapa për të parandaluar financimin e terrorizmit. Krahasuar me vitet e mëparshëm, raporti i vitit 2014 fokusohet në detaje tek masat ligjore dhe institucionale. Ai nxjerr në pah deficitet strategjike, sidomos lidhur me programin e ngrirjes së aseteve terroriste. Sipas Komisionit, Shqipëria duhet të forcojë kapacitetet e saj për të parandaluar radikalizmin, përfshirë masat e duhura për të adresuar fenomenin e luftëtarëve të huaj.<sup>73</sup>

## **4. Përfundime dhe rekomandime**

### *4.1. Përfundime*

---

<sup>72</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian (2006, Maj). *Akte legislative dhe instrumente të tjerë*. ff. 79-80. [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06_en.pdf). (20/07/2015)

<sup>73</sup> EC Staff Working Document (2014). *Albania 2014 Progress Report*. European Commission. [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-albania-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf) (20/07/2015).

Ndonëse vala e largimeve të ekstremistëve shqiptarë për në Siri dhe Irak mund të thuhet se ka ardhur duke u zvogëluar –siç u tha më lart numri i të larguarve për vitin 2015 ka qenë pothuajse zero– nuk mund të pohohet e njëjta gjë për tendencën ideologjike të radikalizmit islamik, siç dëshmojnë edhe seancat e fundit gjyqësore të imamëve dhe individëve të tjerë të akuzuar për veprimtari terroriste.<sup>74</sup> Thelbësor është fakti se në të gjitha seancat gjyqësore ata kanë deklaruar mosnjohjen e ligjit shqiptar dhe dënimin sipas ligjeve të Sheriatit. Ndonëse Shqipëria është një vend me tradita fetare shumë të moderuara dhe bashkëjetesë të spikatur fetare, penetrimi i ekstremizmit islamik gjatë periudhës së parë postkomuniste nëpërmjet fondacioneve arabe dhe aktorëve të tjerë, duket se po i jep tani frytet e tij.

Në mungesë të instrumenteve të qarta de-radikalizuese, të cilat duhet të ndërthurin qasjen strategjike me atë institucionale, policore dhe socio-ekonomike, ekzistojnë pritshmëri të arsyeshme se radikalizimi islamik do të vijojë në hapësirën publike, sidomos brenda grupeve të caktuara më vulnerabël të komunitetit mysliman, duke përdorur si instrument kryesor rrjetet sociale dhe internetin. Këto instrumente do të preferohen gjithnjë e më shumë në të ardhmen për shkak të vështirësisë së aktorëve shtetërorë për t'i kontrolluar ose ndaluar.

Sigurizimi i fenomenit përfshin instrumentalizimin dhe keqpërdorimin e doktrinës së moderuar myslimane fetare, duke sfiduar dhe kërcënuar kësisoj sigurinë kombëtare si dhe duke bërë të domosdoshme dhe legjitimuar politikisht marrjen e masave emergjente për ta luftuar atë. Sikurse përcaktohet edhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (2014), parandalimi, përmbajtja, kontrolli dhe neutralizimi i kërcënimit prej ekstremizmit islamik ka rëndësi të fundamentale për sigurinë kombëtare të Shqipërisë sepse së pari, ai rrezikon bashkëjetesën dhe harmoninë fetare në vend, si aset i paneglizhueshëm i sigurisë kombëtare dhe koherencës shtetërore.

Së dyti, ekstremizmi i dhunshëm, mercenarizmi fetar, radikalizmi islamik, prania dhe përgatitja e xhihadistëve në Shqipëri, e shndërron vendin në territor të ekstremizmit fetar dhe në shënjestër potenciale të veprimtarisë terroriste. Në shtator të vitit 2014, ministri i jashtëm Z. Ditmir Bushati, në një intervistë të përbashkët me ministrin e

---

<sup>74</sup> <http://www.panorama.com.al/rekrutimi-i-shqiptareve-per-ne-siri-imami-ne-gjyq-sjemi-terroriste-njerezit-po-vrasin-e-po-lirohen-mos-kujtoni-se-nuk-i-shohim-lajmet/> (19/07/2015).



jashtëm kanadez, Z. John Baird, ka pranuar se “në disa zona të caktuara të Shqipërisë ka njerëz që janë ushtruar dhe stërvitur për veprime terroriste dhe për të ashtuquajturën Lufta për Xhihad në Siri”<sup>75</sup> Për shkak të kontakteve dhe formimit të një rrjeti rajonal apo global xhihadist, nëse këto forma kërcënimi nuk neutralizohen që në fazat e para të veprimtarisë së tyre, rrezikojnë ta shndërrojnë vendin në një nyje ose portë të xhihadistëve për Evropën dhe Ballkanin.

Së treti, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi islamik kërcënojnë imazhin e vendit dhe rrezikon të formojë një perceptim të gabuar rreth Shqipërisë, e cila është vendanëtar i NATO-s, një kontribuuese e vazhdueshme në luftën kundër terrorizmit që prej fillimit të viteve 2000, dhe vend kandidat për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Shqipëria ka qenë konsistente në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar duke kontribuar me burime njerëzore dhe materiale. Por qeveria dhe shoqëria shqiptare duhet të jenë në gjendje të menaxhojnë kërcënimet që kanë si pikënisje territorin e saj, përpara se të mendojë për të kontribuar jashtë kufijve.

Së katërti, Kërcënimi që i kanoset imazhit të Shqipërisë prej këtyre sfidave të sigurisë ka efekte të drejtpërdrejta negative jo vetëm tek investitorët e huaj që e konsiderojnë vendin në planet e tyre të investimeve, por mund të prodhojë një efekt mjaft negativ dhe frenues mbi turizmin shqiptar.

Së pesti, tendencat radikale, fryma ekstremiste dhe prania e mercenarëve fetarë, sado në formë embrionale, rrezikon të përthithë një vëmendje dis-proporcionale të elitave dhe shoqërisë, duke e larguar atë nga debate për çështje themelore të ndërtimit të demokracisë. Kjo mund të ketë impakt të thellë tek procesi i modernizimit të shoqërisë shqiptare i cili në rastin më të mirë mund të ndalet ose në rastin më të keq të marrë një kthesë së rrezikshme.

Së gjashti, fakti që ky grup luftëtarësh të huaj nga Ballkani, cilatdo qofshin përmasat e tij numerike, përbëhet aktualisht nga shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë apo Shqipërisë, i projekton shqiptarët si ekstremistë, duke minuar pozitën e tyre ndërkombëtare në Ballkan dhe botë.

---

<sup>75</sup> Shih <http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/09/03/shqiptaret-ne-xhihad-bushati-po-luftojme-fenomenin-ska-lidhje-fene/> - 03/07/2015.

Së shtati, me keqpërdorimin e fesë nga ekstremistët islamikë duket se nuk ka vetëm një përpjekje për kriminalizimin e islamit në Shqipëri. Brenda struktura të tyre operojnë edhe struktura të krimit të organizuar, që përbëjnë rrezik edhe më të madh sesa strukturat tradicionale të krimit të organizuar, pasi këto të fundit nuk kanë përqafuar ndonjë ideologji fetare.

Së fundi, ekziston rreziku i instrumentalizimit dhe amplifikimit nëpërmjet mediave lokale dhe ndërkombëtare, duke hiperbolizuar dhe krijuar një situatë imagjinare, duke ofruar terrenin e nevojshëm për të krijuar një problem real dhe mjedisin që do të favorizonte një konflikt fetar në të ardhmen. Një situatë e tillë rrezikon të dëmtojë arritjen e një prej objektivave strategjike madhorë të Shqipërisë, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe të ardhmen e vendit.

#### *4.2. Rekomandime*

Kuptimi i kompleksitetit të ekstremizmit të dhunshëm është një ndër parakushtet e një politike efikase, të bazuar në të dhëna dhe të orientuar drejt rezultateve. Përballja me ekstremizmin ka nevojë për përpjekje të ndërthurur në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Në nivel kombëtar, rol në përballjen me ekstremizmin duhet të kenë familjet, sistemi arsimor, organizatat e shoqërisë civile, komuniteti akademik dhe media, për të nxjerrë në pah seriozitetin e këtij problemi kyç për sigurinë kombëtare të Shqipërisë. Pra duhen ndërthurur faktorët e drejtpërdrejtë (predikimet fetare ekstremiste) me faktorët e tërthortë (varfërinë, papunësinë, izolimin social) që e nxisin këtë fenomen; faktorët sipërfaqësorë (socializimi fetar dhe media sociale) me faktorët precipitues (kalitja morale nëpërmjet materialeve të dhunshme audiovizuale).

Deri në këto momente, Shqipëria nuk ka asnjë program të rehabilitimit të individëve të kthyer apo të de-radikalizimit të individëve të indoktrinuar, të cilët janë identifikuar në fazat më të hershme, përpara se të largohen për t'u përfshirë në konfliktet në Siri dhe Irak, apo përpara se të përfshihen në aktivitete terroriste brenda vendit.

Në lidhje me de-radikalizimin, çdo qasje ka nevojë edhe për analizën psikologjike, që mund të rezultojë vendimtare për të kuptuar në thellësi gjithë procesin e

radikalizimit dhe të ndihmojë individët të ri-integrohen në komunitet. Ka gjithashtu rëndësi fleksibiliteti i qasjeve dhe strategjive, të cilat duhet t'i adresohen jo vetëm radikalizimit në grup/komunitet, por edhe atij individual.

Ekstremizmi i dhunshëm në çdo shtet ka specifikat e tij, sidomos sa u takon faktorëve që nxisin radikalizimin islamik. Pavarësisht se nuk mund të ekzistojë një qasje e vetme, e zbatueshme për të gjitha shtetet perëndimore, apo më specifiku për ato të Ballkanit Perëndimor, eksperiencia tregon se dialogu bashkëpunues dhe konstruktiv midis shoqërisë dhe agjencive qeveritare (në nivel qendror dhe lokal), përbën parakusht të suksesit kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit islamik. Agjencitë qeveritare duhet të ofrojnë mjedisin e përshtatshëm për bashkëpunim mbi hartimin dhe zbatimin e programeve dhe strategjive kundër ekstremizmit të dhunshëm midis grupeve të ndryshme të shoqërisë –si drejtuesit e komuniteteve lokale, liderët fetarë, organizatat joqeveritare, sektori privat dhe media. Fuqizimi i shoqërisë civile në betejën kundër ekstremizmit të dhunshëm mund të sjellë rezultate më efikase, ndërsa bashkëpunimi qeveritar me partnerë jo-qeveritarë sjell më shumë resurse në dispozicion.

Rekomandimet që do të tentojmë të paraqesim në përfundim të këtij studimi, nuk synojnë të shterojnë masat që mund të ndërmarrin institucionet shqiptare dhe aktorët e tjerë, por të paraqesin një hartë të strukturuar dhe të integruar të masave sipas etapave të ndryshme të zhvillimit të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit islamik në Shqipëri. Rekomandimet paraqiten në formën e “*Praktikave të Mira*”, bazuar në dy memorandume të Forumit Global Kundër Terrorizmit: “Memorandumi Hagë-Marakesh”<sup>76</sup> dhe “Memorandumi i Ankarasë”<sup>77</sup>, të ndërthurura për t’iu përshtatur specifikave sociale, ekonomike dhe politike të ekstremizmit në Shqipëri.

## **I. Identifikimi dhe ndërhyrja kundër ekstremizmit të dhunshëm**

---

<sup>76</sup> Memorandumi Hagë-Marakesh (2013) mbi Praktikën e Mira për një Përgjigje më Efikase ndaj Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj: [https://www.thegctf.org/documents/10162/140201/14Sept19\\_The+Hague-Marrakech+FTF+Memorandum.pdf](https://www.thegctf.org/documents/10162/140201/14Sept19_The+Hague-Marrakech+FTF+Memorandum.pdf) (14/05/2015)

<sup>77</sup> Memorandumi i Ankarasë mbi Praktikën e Mira për një Qasje Shumë-Sektoriale në përballje me Ekstremizmin e Dhunshëm. [https://www.thegctf.org/documents/10162/72352/13Sep19\\_Ankara+Memorandum.pdf](https://www.thegctf.org/documents/10162/72352/13Sep19_Ankara+Memorandum.pdf) (14/05/2015).

**Praktika e mirë #1:** Investimi në kultivimin afatgjatë të marrëdhënieve të mirëbesimit me komunitetet e besimtarëve myslimanë më të ekspozuara ndaj rekrutimit, duke shqyrtuar të gjitha çështjet që prekin komunitetin, si varfëria, papunësia, izolimi nga qendrat urbane. Në përgjithësi duhet rivendosur autoriteti i munguar i shtetit në çdo pjesë të territorit shqiptar. Rritja e përgjegjësisë së komunitetit lokal në parandalimin e përhapjes së ekstremizmit islamik dhe rekrutimeve të individëve për të luftuar jashtë Shqipërisë, përmes një fushate të strukturuar informimi.

**Praktika e mirë #2:** Trajtimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit islamik në Shqipëri nuk duhet trajtuar ekskluzivisht si problem sigurie. Si problem shumëdimensional, ai kërkon përgjigje shumë-disiplinore dhe përfshirjen e shumë institucioneve.

**Praktika e mirë #3:** Çdo qasje duhet të marrë parasysh tiparet specifike të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit islamik që shfaq çdo grup individësh (në nivel lokal), por edhe individë të caktuar. Reagimi dhe ndërhyrjet duhet të jenë elastike.

**Praktika e mirë #4:** Përpara formulimit dhe zbatimit të një strategjie (apo plan-veprimi) kundër ekstremizmit dhe radikalizmit duhet kuptuar fillimisht natyra e tij. Duhet identifikuar faktorët që nxisin ekstremizmin e dhunshëm dhe duhen vlerësuar nevojat, objektivat dhe kapacitetet në dispozicion.

**Praktika e mirë #5:** Strategjia kundër ekstremizmit të dhunshëm të institucioneve shqiptare duhet të bazohen në analiza shkencore, të cilat të ndërthurin analizën e sigurisë me modelet shkakësore të radikalizimit, me aspektet psikologjike, apo faktorë të tjerë.

**Praktika e mirë #6:** Çdo program kundër ekstremizmit të dhunshëm duhet të shmangë identifikimin e tij me cilëndo fe, kulturë, përkatësi krahinore, sociale apo komunitare. Kjo kërkon formulimin e një strategjie specifike komunikimi në nivel kombëtar dhe lokal.

**Praktika e mirë #7:** Zhvillimi i një game të gjerë kundër-narrativash dhe aktiviteteve alternative, proaktive dhe pozitive, që ofrojnë alternative jo të dhunshme për të ndihmuar njerëzit në nevojë, si dhe mjetet për të kanalizuar frustrimin, zemërimin dhe shqetësime të tjera, pa iu drejtuar dhunës.

**Praktika e mirë #8:** Fuqizimi i atyre që mund të ndikojnë ndryshimin e sjelljes së një grupi apo komuniteti të caktuar, përfshirë familjet, gratë dhe shoqërinë civile, për të

marrë autorësinë e përçimit të mesazheve pozitive ndaj axhendës së ekstremizmit të dhunshëm.

**Praktika e mirë #9:** Institucionet shtetërore shqiptare (policia, prokuroria dhe institucionet e inteligjencës) duhet të krijojnë programe të strukturuar afatgjata të trajnimit të stafeve të zbatimit të ligjit dhe të drejtuesve të tyre mbi çështje që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin islamik.

## **II. Identifikimi dhe ndërhyrja kundër udhëtimit dhe pjesëmarrjes në luftime: qasje shtetërore ndër-institucionale**

**Praktika e mirë #1:** Grumbullimi, integrimi dhe përpunimi i informacionit të detajuar prej agjencive qeveritare, komuniteteve dhe medias sociale për të identifikuar rekrutimet e mundshme, duke respektuar shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut. Forcimi i bashkëpunimit me ekspertë të shoqërisë civile, akademikë dhe sektorin privat, për të frenuar rekrutimet “online” dhe shndërrimin e medias sociale në instrument rekrutimesh.

**Praktika e mirë #2:** Krijimi i një strukture/agjencie koordinimi/operacionesh është vendimtar për suksesin e çdo strategjie shtetërore kundër ekstremizmit të dhunshëm.

**Praktika e mirë #3:** Zhvillimi i mjeteve të duhura ligjore dhe procedurave administrative për të zvogëluar në maksimum rrezikun nga vullnetarizmi ose mercenarizmi ekstremist.

**Praktika e mirë #4:** Aplikimi i masave të duhura të identifikimit për të ndaluar udhëtimin e luftëtarëve të huaj për në zonat e konfliktit, veçanërisht nëpërmjet rrugëve ajrore. Shqipëria duhet të forcojë koordinimin me strukturat partnere të inteligjencës, si dhe mekanizmat kontrollues në kohë reale të të dhënave për individët e përfshirë në aktivitete të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit islamik, duke përdorur të gjitha mjeteve në dispozicion për të parandaluar keqpërdorimin e dokumenteve të udhëtimit, me objektiv pjesëmarrjen në luftë.

## **III. Identifikimi dhe ndërhyrja pas kthimit**

**Praktika e mirë #1:** Aktorët shtetërorë dhe institucionalë duhet të inkurajojnë kthimet vullnetare dhe të japin garancitë e duhura për individët e kthyer të cilët tregojnë gatishmëri të bashkëpunojnë me autoritetet.

**Praktika e mirë #2:** Përdorimi një numri sa më të gjerë burimesh informacioni për t'u paraprirë dhe për të identifikuar të rikthyerit. Siç rekomandon edhe OSBE, një prej instrumenteve shumë efikase mund të jenë projektet e policimit në komunitetet specifike më të ekspozuara ndaj fenomenit.

**Praktika e mirë #3:** Ndërtimi i sistemeve të vlerësimit të bazuara tek të dhënat dhe i modeleve analitike individuale të vlerësimit të rrezikut për të kthyerit, për të analizuar gjendjen e tyre dhe për të përcaktuar qasjet e duhura psiko-sociale për t'i ri-integruar ata.

**Praktika e mirë #4:** Forcimi i hetimeve dhe ndjekjeve penale për ekstremistët e kthyer, përmes përmirësimit të ndarjes së informacionit dhe grumbullimit të të dhënave.

**Praktika e mirë #5:** Përgatitja dhe testimi i kundërpërgjigjeve ndaj llojeve të sulmeve terroriste për të cilat ekstremistët e dhunshëm të kthyer në atdhe mund të jenë të specializuar.

**Praktika e mirë #6:** Zhvillimi i programeve gjithëpërfshirëse të ri-integrimit social, ekonomik dhe kulturor.

#### **IV. Ndërtimi i partneriteteve publik-privat-shoqëri civile**

**Praktika e mirë #1:** Rritja e pavarësisë financiare dhe administrative e KMSH-së nëpërmjet financimit të veprimtarive të saj nga buxheti i shtetit.

**Praktika e mirë #2:** Forcimi i Komitetit të Kulteve, duke i shtuar atij kompetencat dhe stafin, për të koordinuar dhe rritur efikasitetin e bashkëpunimit midis autoriteteve shtetërore dhe aktorëve të tjerë (KMSH-së, shoqërisë civile).

**Praktika e mirë #2:** Element kritik për çdo program të suksesshëm kundër ekstremizmit të dhunshëm përbën zhvillimi i koncepteve të njëjta mbi natyrën e fenomenit midis agjencive qeveritare dhe aktorëve jo-qeveritarë.

**Praktika e mirë #3:** Shoqëria civile mund të kontribuojë në përballje me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin islamik në Shqipëri: i) duke promovuar narrativa dhe mesazhe kundër dhunës; ii) nëpërmjet ekspertizës së qendrave kërkimore të specializuara

në analizën e fenomeneve të sigurisë, si *think-tank*-et; iii) nëpërmjet ekspertizës së studiuesve dhe akademikëve të universiteteve, me eksperiencë të gjerë shkencore brenda dhe jashtë vendit; iv) duke paraqitur mjete alternative dhe jo të dhunshme për të arritur objektiva të përbashkët; si dhe v) duke shërbyer si urë bashkëpunimi midis institucioneve qendrore dhe komuniteteve të ekspozuara ndaj radikalizmit islamik dhe ekstremizmit të dhunshëm.

**Praktika e mirë #4:** Duhet të sigurohet pjesëmarrje thelbësore e komunitetit për të mobilizuar resurset e veta në aktivitetet kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit islamik.

**Praktika e mirë #5:** Institucionet shqiptare duhet të bashkëpunojë ngushtë me shoqërinë civile dhe ta ndihmojë atë në aktivitete që lidhen me përballjen me radikalizmin islamik.

## **V. Qasje socio-ekonomike kundër ekstremizmit të dhunshëm**

**Praktika e mirë #1:** Çdo qasje duhet të shënjestrojë të rinjtë që rrezikohen nga radikalizimi dhe rekrutimi si mercenarë/vullnetarë fetarë.

**Praktika e mirë #2:** Institucionet arsimore mund të shërbejnë si platformë e rëndësishme në përballje me ekstremizmin e dhunshëm.

**Praktika e mirë #3:** Promovimi i shanseve ekonomike për komunitetet që rrezikohen mund të adresojë një gjendje që nxit ekstremizmin e dhunshëm.

**Praktika e mirë #4:** Gratë mund të bëhen aktor i rëndësishëm lokal në përballje me ekstremizmin e dhunshëm.

## **VI. Roli i Komunitetit Mysliman Shqiptar**

**Praktika e mirë #1:** Forcimi i kontrollit në të gjitha xhamitë dhe objektet e tjera të kultit, duke e bërë KMSH-në autoritetin e vetëm fetar që përfaqëson besimtarët myslimanë. KMSH duhet të identifikojë hapat e duhur –edhe me mbështetjen e institucioneve shtetërore– për të vendosur nën kontroll edhe disa xhami që aktualisht ndodhen jashtë autoritetit të saj.

**Praktika e mirë #2:** Forcimi i bashkëpunimit me institucionet shtetërore, nëpërmjet një marrëveshjeje kuadër ku të përcaktohet një “Hartë Masash kundër Ekstremizmit”.

**Praktika e mirë #3:** Zhvillimi i iniciativave/takimeve të hapura publike me komunitetet e besimtarëve myslimanë jo vetëm në rajonet më të ekspozuara ndaj ekstremizmit, por në të gjitha qarqet e vendit, ku të adresohet teologjikisht keq-përdorimi i fesë islame dhe keq-interpretimi i teksteve të shenjta.

**Praktika e mirë #4:** Fuqizimi i rolit të Këshillit të Teologëve, për të adresuar teologjikisht keqinterpretimin e fesë për interesa ekstremiste.

**Praktika e mirë #5:** Forcimi i bashkëpunimit me autoritetet lokale, sidomos në rajonet më të ekspozuara ndaj radikalizmit islamik.

**Praktika e mirë #6:** Fuqizimi i rolit të të rinjve dhe të gruas brenda Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe një shtrirje më kapilare e zyrave dhe aktiviteteve rinore/të gruas në të gjithë vendin, në drejtim të përbaljes me fenomenin e ekstremizmit islamik.

**Praktika e mirë #7:** Forcimi i arsimit teologjik dhe i klerikëve në Shqipëri, në institucione shtetërore/publike dhe private.

## 5. Metodologjia

Nga pikëpamja metodologjike, studimi bazohet në ndërthurjen e analizës cilësore me atë sasimore. Pas shqyrtimit të literaturës bashkëkohore mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin fetar identifikuar elementët kyçë, më të përshtatshëm dhe më efikasë për ta hulumtuar atë në Shqipëri. Më pas është hartuar një “*Hartë Rruge*” metodologjike, duke identifikuar objektivat kërkimore që do të synonte të verifikonte analiza cilësore dhe sasimore. Bazuar në të dhënat paraprake dhe shqyrtimin e literaturës, është hartuar një sondazh për të matur perceptimin e opinionit publik mbi ekstremizmin dhe radikalizmin në Shqipëri. Sondazhi është zhvilluar në nivel kombëtar gjatë periudhës mars-prill 2015 me pjesëmarrjen e 1200 të intervistuarve, të shpërndarë në mënyrë proporcionale (referuar të dhënave të Censurit më të fundit të popullsisë) sipas gjinisë, nivelit arsimor, punësimit dhe përkatësisë fetare. Përveç matjes së perceptimit publik, instrumente të tjera kërkimore përfshijnë intervista gjysmë të strukturuara me aktorë kyçë, monitorimin e



mediave si dhe shqyrtimin e kuadrit ligjor e institucional, të brendshëm dhe ndërkombëtar ku është përfshirë Shqipëria.

## 6. Bibliografia

- Abrahams, F. (2015, Qershor). *Berisha dhe Lidhja Islamike nga Arabia Saudite në Luftën e Bosnjës*. BIRN (Balkan Investigative Reporting Network). <http://www.mapo.al/2015/06/berisha-dhe-lidhja-islamike-nga-arabia-saudite-ne-luften-e-bosnjes> (03/07/2015).
- Alic, A. (2009, 11 Dhjetor). *Re-Arrests Hope to Prove Bosnia Terror Plots*. ISN Security Watch.
- Archick, K. & Belkin, P. (2015, Prill). *European Fighters in Syria and Iraq: Assessments, Responses, and Issues for the United States*. US: Congressional Research Service, 7-5700, R44003.
- Azinovic, V. & Jusic, M. (2015). *The Lure of the Syrian War: The Foreign Fighters' Bosnian Contingent*. Atlantic Initiative, Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë.
- Bardon, G. (2015). *ISIS Balkan Networks*, American Centre for Democracy, Working Paper. <http://acdemocracy.org/isis-balkan-networks-04/07/2015>.
- Barrett, R. (2014, Nëntor), *The Islamic State*, The Soufan Group, US: New York.
- Barro, R. (2002, Qershor). *The Myth That Poverty Breeds Terrorism*. Business Week.
- Bogdani, A. & Bezaj, F. (2014, 16 Dhjetor). *Dhjetëra fëmijë shqiptarë "pengje" të xhihadistëve në Siri*. Reporter.al. <http://www.reporter.al/dhjetra-femije-shqiptare-pengje-te-xhihadisteve-ne-siri/> (20/07/15).
- Bumçi, A. (2004). *Çështje të Sigurisë Kombëtare. Rasti i Shqipërisë. Kufiri, feja, korrupsioni*. Tiranë: AIIS Press.
- Buzan, B. & Waever, O. & De Wilde, J. (1998). *Security: A New Framework for Analysis*. Nju Jork: Lynne Rienner Publisher.
- Byman, D. & Shapiro, J. (2014, Nëntor). *Be Afraid. Be a Little Afraid. The Threat of Terrorism from Western Foreign Fighters in Syria and Iraq*. Policy Paper No. 34, Foreign Policy Series, Brookings Institution.
- Bytyci, F. (2014). *Indebted to America, Kosovo Struggles to Curb Islamist Recruits*. Reuters.
- CODEXTER (2014, Nëntor). *Profiles of Counter-Terrorist Capacity: Albania*. Council of Europe.
- Denoex, G. (2009, Shkurt). *Guide to the Drivers of Violent Extremism*. [http://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/Pnadt978.pdf](http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf) (08/07/2015).
- Denoex, G. (2002, Qershor). *The Forgotten Swamp: Navigating Political Islam*. Middle East Policy, Vëll. 9.
- Emmers, R. (2006). *Sigurizimi*, në Collins, A. (ed.). *Çështje Bashkëkohore të Sigurisë*. UK: Oxford University Press, Kreu 7.
- Fuller, G. (2003). *The Future of Political Islam*. Nju Jork: Palgrave MacMillan.

- Gjinishi, E. (2006, Tetor). *Historical Background to the Muslim Community in Albania*, NATO Advanced Research Workshop “Strengthening and Promoting Religious Tolerance and Co-Existence in the Balkans and Beyond”, Tiranë.
- Hoffman, B. (1997). *Terrorism and WMD: Some Preliminary Hypotheses*, në Non-Proliferation Review, Vol. 4, No. 3.
- Holman, T. (2014, Qershor). *Foreign Fighters from the Western Balkans in Syria*. Vol. 7, Nr. 6, ff. 8-10.
- Intervistë me Arben Ramkaj, Myftiu i Elbasanit.
- Intervistë me Ermir Gjinishin, Ish Zv/Kryetar i Komitetit Mysliman.
- Intervistë me Ilir Hoxhollin, Kreu i Komitetit Shqiptar të Kulteve.
- Intervistë me Skënder Hysenin, Ministër i Brendshëm i Kosovës. VOA (2015, 20 shkurt).
- Islamophobia Research and Documentation Centre, University of California, Berkeley. <http://crg.berkeley.edu/content/islamophobia/defining-islamophobia>.
- Jenkins, B. M. (2015). *When Jihadis Come Marching Home. The Terrorist Threat Posed by Westerns Returning from Syria and Iraq*. Perspectives, 130-1-RC.
- Ligji 10192, datë 14/11/2009, për “Parandalimin e krimit të organizuar dhe trafikeve nëpërmjet masave parandaluese kundër pronës”.
- Lutz, J. & Lutz, B. (2008). *Global Terrorism*, 2<sup>nd</sup> edn, Nju Jork: Routledge.
- Lynch, C. (2013, Korrik). *Europe’s New ‘Time Bomb’ is Ticking in Syria*. Foreign Policy.
- Mendelsohn, B. (2009). *Combating Jihadism: American Hegemony and Interstate Cooperation in the War on Terrorism*, US, Chicago: The University of Chicago Press.
- Nelson, F. (2015, Janar). *Six key points from MI5’s Andrew Parker speech on the terror threat in Britain*. UK: The Spectator.
- Neni 265 (a,b dhe c) i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
- Neuman, P. (2015, Janar) *Foreign Fighter Total in Syria/Iraq now exceeds 20.000*. ICSR Info-Press Release.
- Reuter, C. (2015, 18 Prill). *The Terror Strategist: Secret Files Reveal the Structure of Islamic State*. Der Spiegel.
- Roy, O. (1994). *The Failure of Political Islam*. US, Cambridge, MA: Harvard University Press.
- Shtuni, A. (2015, Prill). *Albanian Foreign Fighters in Syria and Iraq*. CTC Sentinel, Vol. 8, Nr. 4.
- The Economist (2014, 30 Gusht). “*It Ain’t Half Hot Here, Mom. Why and How Westerns go to Fight in Syria and Iraq*”, <http://www.economist.com/news/middle-east-and-africa/21614226-why-and-how-westerners-go-to-fight-syria-and-iraq-it-aint-half-hot-here-mum> (28/06/2015).
- Today’s Zaman (2014, 6 Shtator). [http://www.todayzaman.com/anasayfa\\_turkey-main-transit-route-for-balkan-fighters-to-syria-iraq\\_357854.html](http://www.todayzaman.com/anasayfa_turkey-main-transit-route-for-balkan-fighters-to-syria-iraq_357854.html) (20/06/2015).
- Veldhuis, T. & Staun, J. (2009, Tetor). *Islamist Radicalisation: A Root Cause Model*. Netherland Institute for International Relations.
- Vickers, M. (2008). *Islam in Albania*. UK: Defense Academy of the United Kingdom

- Washington Post (2014, 11 Tetor). *Foreign Fighters Flow to Syria*,  
[http://www.washingtonpost.com/world/foreign-fighters-flow-to-syria/2014/10/11/3d2549fa-5195-11e4-8c24-487e92bc997b\\_graphic.html](http://www.washingtonpost.com/world/foreign-fighters-flow-to-syria/2014/10/11/3d2549fa-5195-11e4-8c24-487e92bc997b_graphic.html) (02/07/2015)
- Wilkinson, P. (2000). *The Strategic Implications of Terrorism*. Indian Council of Social Science Research, India: Har-Anand Publications.
- Woehrel, S. (2005). *Islamic Terrorism and the Balkans*. CRS Report for Congress, RL33012.  
<https://www.fas.org/sgp/crs/terror/RL33012.pdf> (11/04/2015).
- <http://icsr.info/2015/01/foreign-fighter-total-syriairaq-now-exceeds-20000-surpasses-afghanistan-conflict-1980s> (02/07/2015).
- [http://www.foreignpolicy.com/articles/2013/07/09/european\\_fighters\\_jihadists\\_syria?page=0,1](http://www.foreignpolicy.com/articles/2013/07/09/european_fighters_jihadists_syria?page=0,1)  
(14/04/2015).
- <http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2014/08/balkan-fighters-abroad> (22/06/2015).
- <http://www.ibtimes.com/balkans-track-isis-fighters-flowing-through-turkey-overwhelmed-lax-border-control-1980602>. (10/05/2015)
- <http://www.gazetama.net/web/2014/09/14/ne-siri-dhe-irak-deri-tani-40-shqiptare-te-vrare/> (06/07/2015)
- <http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/09/03/shqiptaret-ne-xhihad-bushati-po-luftojme-fenomenin-ska-lidhje-fene/> (03/07/2015).
- <http://soufangroup.com/foreign-fighters-in-syria/> (22/07/2015)
- <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-29043331> (09/07/2015)
- <http://www.oranews.tv/vendi/rekrutonin-shqiptare-per-ne-siri-7-te-arrestuar-mes-tyre-dhe-dy-imame-jamrat/> (05/07/2015)
- <http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-punes.aspx?tab=tabs-5> (30/06/2015).
- [http://www.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi\\_i\\_varferise\\_2012\\_.pdf](http://www.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi_i_varferise_2012_.pdf) (30/06/2015).
- <https://www.gov.uk/government/publications/the-use-of-social-media-for-online-radicalisation>  
(20/07/2015).
- <http://www.reporter.al/dosja-e-xhihadit-rol-i-imameve-ne-rekrutimin-e-militanteve-shqiptare/>  
(08/07/2015).
- [http://www.nypdshield.org/public/SiteFiles/documents/NYPD\\_Report-Radicalization\\_in\\_the\\_West.pdf](http://www.nypdshield.org/public/SiteFiles/documents/NYPD_Report-Radicalization_in_the_West.pdf)  
(08/07/2015)
- <http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2013/224822.htm> (12/07/2015).
- [https://treaties.un.org/Pages/DB.aspx?path=DB/studies/page2\\_en.xml](https://treaties.un.org/Pages/DB.aspx?path=DB/studies/page2_en.xml) (12/07/2015).
- <http://www.osce.org/fsc/119814?download=true> (12/07/2015).
- [http://www.pp.gov.al/web/kodi\\_penal\\_2013\\_shtatordoc\\_823.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2013_shtatordoc_823.pdf) (12/07/2015).
- <http://www.panorama.com.al/rekrutimi-i-shqiptareve-per-ne-siri-imami-ne-gjyq-sjemi-terroriste-njerezit-po-vrasin-e-po-lirohen-mos-kujtoni-se-nuk-i-shohim-lajmet/> (19/07/2015).